



16



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

NDËRVEPRIMI BIZNES – BASHKI MBI TRANSPARENCËN, SHËRBIMET DHE ZHVILLIMIN EKONOMIK VENDOR

Tiranë, Janar 2020



LISTA E SHKURTIMEVE

Ky dokument pune është përgatitur nga ekspertët e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve në kuadër të mbledhjes XIX të Këshillit të Investimeve (27 janar 2020), z. Elvis Zerva, ekspert ligjor dhe rregullator, znj. Elida Fara, eksperte për ekonominë, znj. Xaira Shurdha, eksperte për monitorimin dhe ndërlidhjen, nën drejtimin e Drejtores së Sekretariatit, znj. Diana Leka (Angoni). Mbështeti në organizimin e takimeve dhe mbledhjeve me partnerë si dhe në redaktimin gjuhësor të materialit, znj. Elisa Lula, oficere administrative dhe komunikimit pranë Sekretariatit. Falenderojmë subjektet private, dhomat e tregtisë (Tiranë, Shkodër, Gjirokastër), shoqatat e biznesit (Amcham, FIAA, Confindustria Albania, DIHA, etj.), përfaqësuesit e institucioneve qendrore dhe të njësisve të vetqeverisjes lokale (Tiranë, Korçë, Elbasan, Shkodër), shoqatat e bashkive që bashkëpunuan me Sekretariatit në parashtrimin e problematikave dhe procesin e konsultimit të materialit.

NJVQV	Njësi të Vetëqeverisjes Vendore
ATV	Administrata Tatimore Vendore
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
PEFA	Llogaridhënia për shpenzimet dhe financat publike
KB	Këshilli Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
KI	Këshilli i Investimeve
BE	Bashkimi Evropian
AmCham	Dhoma Amerikane e Tregtisë dhe Industrisë
FIAA	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri
DIHA	Dhoma Gjermane e Tregtisë dhe Industrisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PBB	Produkt i Brendshëm Bruto
EJL	Evropa Jug-Lindore
ALL	Albanian Lek
PVZh	Planet Vendore të Zhvillimit
KLSh	Kontrolli i Lartë i Shtetit
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
AZRT	Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale
DPTTV	Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore
AZHT	Agjencia për Zhvillimin Territorial
NVM	Ndërmarrje të Vogla e të Mesme
TEDA	Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
METODOLOGJIA	7
SKONTEKSTI	9
PROBLEMATIKA TË EVIDENTUARA	10
REZULTATET E ANKETËS	10
PROBLEMATIKAT KRYESORE NGA RAPORTET KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE	12
PROBLEMATIKA TË REFERUARA NGA BIZNESI	13
GJETJE KRYESORE	14
REKOMANDIME	30
SHTOJCA 1	34
BIBLIOGRAFIA	44

HYRJE

Reforma Administrative-Territoriale nga pikëpamja formale u materializua me miratimin e ligjit 115/2014 “Për Ndarjen Administrative-Territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” sipas të cilit qeverisja vendore u riorganizua në 61 bashki dhe 12 qarqe. Thelbi i fazës së parë të reformës ishte ndarja hartografike e njësive të vetëqeverisjes vendore. Kjo u pasua me nisjen e procesit të harmonizimit gradual të legjislacionit në lidhje me financat, taksat dhe tatimet në nivel vendor në funksion të rritjes së decentralizimit dhe të efikasitetit në përdorimin e burimeve.

Reforma e nisur nuk i zgjidhi të gjitha sfidat e njësive të vetëqeverisjes vendore. Sipas Raportit të Progresit për Shqipërinë për vitin 2019 nënvizohet se: “*Shumica e bashkive nuk janë efektive në mbledhjen e të ardhurave. Si rezultat, aftësia e tyre në përgjithësi për të ofruar shërbime publike cilësore mbetet e kufizuar*”. Edhe sipas vlerësimit të sistemeve të menaxhimit financiar në nivel vendor (PEFA, 2017), “*Sfidat kryesore për bashkitë lidhen me performancën e ulët në mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Realizimi i ulët i planit bën që bashkitë më pas të ulin shpenzimet e parashikuara në fillim të vitit dhe si rezultat krijojnë borxhet e këqija. Ndërkohë, mungojnë sisteme efektive të monitorimit të ekzistencës dhe ecurisë së*

detyrimeve të prapambetura, të cilat janë një risk për disiplinën fiskale vendore”. Si rezultat, burimet e kufizuara financiare të bashkive, ngushtojnë mundësitë e mbështetjes ndaj biznesit kryesisht atij të vogël dhe të mesëm dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara. Kjo problematikë evidentohet në nivele të ndryshme, në varësi të mjeteve dhe burimeve financiare në dispozicion të bashkive të ndryshme. *Mbetet për t'u parë më konkretisht cilësia e ofrimit të shërbimeve ndaj subjekteve në ato bashki që janë më të shëndetshme nga pikëpamja financiare si p.sh. Bashkia Tiranë. Por a ekziston një standard shërbimi bazë për të gjykuar mbi nivelin e cilësisë së shërbimit?*

Mirëadministrimi fiskal mbetet parakusht i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik lokal dhe stimulimin e investimeve. Zhvillimi ekonomik lokal¹, është një proces i partneritetit strategjik, i cili ndihmon në: a) rritjen e produktivitetit (një objektiv kryesor ekonomik) me anë të stimulimit të investimeve në bizneset e reja apo edhe ato ekzistuese me potencial të lartë të rritjes; b) krijimin e kushteve lokale për të siguruar rritje të qëndrueshme mbi ekonominë lokale/kombëtare (p.sh. infrastruktura, uji, energjia, etj.) Në këtë kuptim zhvillimi ekonomik në nivel vendor ndihmon për të hedhur themelet e një prosperiteti lokal dhe kombëtar.

¹ Burimi: Ewen Peters

Më specifikisht, ndërveprimi i biznesit me bashkitë është identifikuar në disa tema të diskutuara që prej 2015 në KI dhe konkretisht: *Platforma e-Leje, Informaliteti në Turizëm, Inspektimet, Reforma e Pronësisë*. Në këto tema janë trajtuar disa nga aspektet ligjore dhe rregullatore të proceseve dhe shërbimeve të cilat ofrohen nga bashkitë për komunitetin e biznesit. Për këtë qëllim janë mbajtur shënime disa nga pritshmëritë e biznesit ndaj bashkive të cilat lidhen kryesisht me ofrimin cilësor të shërbimeve vendore kundrejt taksave dhe tarifave që paguan biznesi, transparencën e përdorimit të fondeve dhe planet konkrete të zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturor.

Nisur nga sa më sipër dhe duke konsideruar votimin e anëtarëve të KI për trajtimin në një mbledhje të posaçme të këtij ndërveprimi, Sekretariati u fokusua në dy komponentë kryesorë: *taksa dhe tarifave vendore në kuadër të decentralizimit fiskal dhe rolin e bashkive në zhvillimin ekonomik vendor*.

Kjo notë teknike nuk merr përsipër të analizojë të gjitha problematikat e bashkive në kuadër të decentralizimit dhe ndërveprimit me biznesin dhe as të japë rekomandime shteruese për zgjidhjen e tyre. Ajo synon të prioritetizojë disa aksione konkrete të cilat përmirësojnë raportet bashki-biznes dhe rrisin transparencën e kërkuar.

METODOLOGJIA

Hapat e ndërmarra nga Sekretariati për të vlerësuar mirëadministrimin fiskal në nivel vendor dhe rolin e bashkive në zhvillimin ekonomik janë si më poshtë vijon:


- (i) Hulumtimi i strategjive, dokumentave, ligjeve dhe akteve nënligjore të miratuara ndër vite;
- (ii) Hulumtimi i raporteve ndërkombëtare dhe kombëtare të tilla si Raport Progresi i Komisionit Evropian, Vlerësimi mbi Sistemet e Menaxhimit Financiar të Bashkive, Raporti PEFA², Raporti Vjetor mbi Financat Publike Vendore, Ministria e Financave; Raporti Vjetor-Audit i Performancës i Kontrollit të Lartë të Shtetit, etj.
- (iii) Analiza e problematikave nga bizneset e veçanta dhe shoqatat e biznesit të depozitu-

ara në Sekretariatat përgjatë periudhës 2015-2020.


- (iv) Anketa e Sekretariatit (2019) – Anketa u realizua nëpërmjet një pyetësori të strukturuar të përgatitur nga Sekretariati. Ky pyetësor u plotësua rastësisht online në mënyrë anonime nga 300 biznese. Anketa u publikua në shqip dhe anglisht në faqen e internetit të KI, mediat sociale (Facebook, Twitter) si edhe u dërgua me e-mail në rreth 8.000 biznese, nga të cilat rreth 3.000 u kontaktuan edhe me telefon. Është bashkëpunuar me Universitetin Epoka për asistencë në përpunim statistikor dhe certifikimin e rezultateve. Anketa u plotësua nga biznese në të 12 qarqet e vendit. Sipas madhësisë, 64% e të anketuarve ishin biznese me xhiro mbi 8 milion ALL, 25% biznese me xhiro 5-8 milion ALL dhe pjesa tjetër ishin biznese me xhiro deri në 5 milion ALL.

² <https://pefa.org/country/albania>

Figura 1. Të anketuarit sipas qarkut dhe xhiros vjetore



■ Berat ■ Elbasan ■ Korçë ■ Shkodër
 ■ Dibër ■ Fier ■ Kukës ■ Tiranë
 ■ Durrës ■ Gjirokastrë ■ Lezhë ■ Vlorë



■ mbi 8 milionë ALL
 ■ deri 5 milionë ALL
 ■ nga 5-8 milionë ALL

- (v) Konsultime direkte të Sekretariatit në bashkëpunim me Shoqatën për Autonominë Vendore me Bashkitë Tiranë, Korçë dhe Elbasan;
- (vi) Konsultime direkte me biznesin, Bashkinë Shkodër si edhe me Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë;
- (vii) Konsultime në nivel teknik - “Fokus Group” - organizuar nga Bashkia Korçë me biznesin

lokal dhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë me anëtarët e saj, 2 takime me 27 pjesëmarrës;

- (viii) Sekretariati i KI-së ka marrë komente me shkrim mbi problematikat dhe çështjet konkrete që hasin bizneset në lidhje me ndërveprimin me pushtetin vendor në veçanti nga AmCham, FIAA, Confindustria dhe DIHA.

KONTEKSTI

Autonomia vendore është e drejta dhe aftësia e njësive të vetëqeverisjes vendore, të krijuara sipas legjislacionit, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë.

Marrëdhëniet ndërmjet organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të qeverisjes qendrore bazohen në parimet e subsidiaritetit³, të konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta. Bashkive u garantohet e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur, e drejta për të përfituar transfertë (ndahet sipas kriterëve të përcaktuara në ligj) të pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit, e drejta për të përfituar nga ndarja e të ardhurave nga taksat kombëtare dhe tatimet. Bashkitë kanë autonomi të plotë në përdorim-

in e të ardhurave të veta, të transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurave nga taksat e ndara. Funkcionet ose kompetencat që u transferohen apo delegohen Bashkive, si dhe vendosja e një standardi të ri kombëtar për kryerjen e funksioneve ose kompetencave, shoqërohen kurdoherë me mjetet dhe burimet e nevojshme financiare për ushtrimin e tyre.

Më specifikisht, bashkitë financohen nga të ardhurat që sigurohen nga (1) taksat, tarifatat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga (2) fondet e transferuara nga buxheti i shtetit dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave e tatimeve kombëtare, (3) huamarrja vendore, donacionet, si dhe burime të tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Në Shtojcën 1 është paraqitur një pasqyrë e plotë nga pikëpamja funksionale, ligjore dhe institucionale për njësitë e vetëqeverisjes vendore pas reformës. Kjo analizë ka për qëllim evidencimin e problematikave dhe gjetjeve konkrete si më poshtë në kuadrin e marrëdhënies biznes-bashki.

³ “Subsidiaritet” është parimi i kryerjes së funksioneve dhe ushtrimit të kompetencave në një nivel qeverisjeje sa më pranë komunitetit, duke pasur parasysh rëndësinë dhe natyrën e detyrës, si dhe kërkesat e efikasitetit dhe të ekonomisë.

PROBLEMATIKA TË EVIDENTUARA

1. REZULTATET E ANKETËS


Anketa e realizuar nga Sekretariati, me fokus ndërveprimin e sektorit privat me bashkitë përfshin të dhëna të raportuara gjatë periudhës korrik – shtator 2019. Pyetjet u hartuan për të mbledhur informacion në lidhje me transparençën kundrejt biznesit, cilësinë e shërbimeve të ofruara në raport me tarifat e paguara nga biznesi dhe ofrimin e shërbimeve elektronike si edhe përdorimin e tyre nga ana e biznesit.

Transparenca në nivel lokal


Bizneset janë përgjithësisht të informuar mbi legjislacionin fiskal vendor (86% janë plotësisht/pjesërisht të informuar) dhe mbi procedurat tatimore vendore (71% janë të qartë ose shumë të qartë). Trendi është i njëjtë në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe madhësisë së biznesit.

Figura 2. Transparenca mbi taksat/tarifat vendore dhe procedurat administrative vendore

A jini të informuar në lidhje me taksat dhe tarifat që paguani, dhe mënyrën e llogaritjes së tyre?



Si e vlerësoni ju qartësinë e informacionit të ofruar nga ATV në lidhje me procedurat administrative tatimore vendore?




Mungesa e informacionit në lidhje me VKB e miratuara në bashkinë e tyre konsiderohet problem nga ana e kompanive të anketuara (88% e kompanive shprehen se nuk kanë informacion në lidhje me vendimet e miratuara nga Këshillat Bashkiakë).


Biznesi me xhiro mbi 8 milionë ALL ka përqindjen më të lartë të pagartësisë së procedurave tatimore vendore, 37% e tyre deklarojnë se informacioni i dhënë nga ATV në lidhje me procedurat tatimore është i paqartë dhe kryesisht biznesi i cili operon në sektorin e industrisë, ku 48% e tyre deklarojnë se kanë pagartësi në lidhje me procedurat tatimore vendore.

Figura 3. Transparenca në lidhje me VKB dhe përputhshmëria e tyre me legjislacionin në fuqi

A ju informon Bashkia juaj në lidhje me vendimet më të fundit të Këshillave Bashkiakë dhe ndikimit të tyre në veprimtarinë tuaj?



A i vlerësoni si të pajtueshme me legjislacionin në fuqi VKB?




Pavarësisht madhësisë së biznesit apo sektorit ku operojnë, ata deklarojnë se janë të painformuar nga bashkitë në lidhje me VKB e miratuara (sektori i bujqësisë ka edhe përqindjen më të lartë në lidhje me mos-informimin). Bizneset shprehin mungesë besimi në vendim-marrjen e institucioneve vendore në raport me legjislacionin qendror (vetëm 11% mendojnë se VKB-të janë në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin qendror dhe rreth 56% deklarojnë se ndikohen mjaftueshëm nga VKB-të). Kryesisht bizneset që operojnë në sektorin e bujqësisë kanë edhe tendencën e besueshmërisë së ulët ndaj vendim-marrjes së bashkive (71% e tyre i konsiderojnë aspak të pajtueshëm VKB-të me legjislacionin në fuqi).

Cilësia e shërbimeve të ofruara, Raporti Kosto – Përfitim

Në masë të konsiderueshme, biznesi shprehet i pakënaqur nga shërbimet vendore krahasuar me tarifat e paguara (78% konsiderojnë pak/aspak të drejtë raportin kosto-përfitim). Në rang sektori, bujqësia dhe industria janë sektorët më të pakënaqur në lidhje me shërbimet e përfituara nga bashkia dhe tarifat e paguara.

Figura 4. Kënaqësia e biznesit në lidhje me shërbimet vendore

A e konsideroni të drejtë balancën mes shërbimit të përfituar dhe tarifave vendore që paguani?




Shërbimet elektronike të ofruara në nivel vendor

Institucionet vendore nuk ofrojnë shërbime elektronike (76% e kompanive të anketuara deklarojnë se nuk përfitojnë shërbime elektronike nga bashkitë e tyre/nuk e dinë nëse ajo ofron). Sektori i ndërtimit dhe ai i shërbimeve janë sektorët që përfitojnë/shfrytëzojnë më shumë shërbimet elektronike të ofruara nga bashkitë, respektivisht 38% dhe 24% e kompanive deklaruan se përfitojnë nga shërbimet elektronike të bashkive.

Figura 5. Shërbimet elektronike në nivel vendor

A përfiton shërbime elektronike nga Bashkia juaj?



2. PROBLEMATIKAT KRYESORE NGA RAPORTET KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

Sekretariati ka konsideruar një sërë raportesh kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat kanë identifikuar problematikat që lidhen me reformën territoriale, decentralizimin fiskal të njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe rolin e bashkive në ofrimin e shërbimeve.

1. Konkretisht në Raport Progresin për Shqipërinë për vitin 2019 nënvizohet se:

Shumica e bashkive nuk janë efektive në mbledhjen e të ardhurave. Si rezultat, aftësia e tyre në përgjithësi për të ofruar shërbime publike cilësore mbetet e kufizuar.

2. Vlerësimi mbi sistemet e Menaxhimit Financiar Publik, kryer sipas metodologjisë PEFA⁴ mbi pesë bashki të vendit nxori në pah sfidat e pushtetit vendor. Sipas saj, *sfida kryesore për bashkitë ka të bëjë me performancën e ulët në mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifrat vendore. Realizimi i ulët i planit bën që bashkitë më pas të ulin shpenzimet e parashikuara në fillim të vitit dhe si rezultat krijohen detyrimet e prapambetura.*
3. KLSH në Raport Auditimit e Performancës “Funksionimi i Bashkive në Kuadër të Reformës Administrative-Territoriale” (2018) evidenton *problemet në kuadrin ligjor dhe rregullator të vetëqeverisjes vendore parë në këndvështrimin e reformës administrative territoriale dhe ecurisë së saj*⁵.
4. Probleme në lidhje me *mundësitë reale të bashkive për të krijuar të ardhura dhe për të ofruar shërbime më të mira* janë evidentuar edhe nga vetë bashkitë apo shoqatat e tyre⁶.

⁴ <https://pefa.org/country/albania>

⁵ Në legjislacionin e ri ekzistojnë “zona gri”, boshllëqe, në përcaktimin e kompetencave të bashkive dhe kalimi i kompetencave të reja nuk është bërë i plotë dhe nuk është shoqëruar me ndryshimet në ligjet përkatës, duke mos përcaktuar kështu qartazi se çfarë detyrash ka pushteti qendror dhe çfarë detyrash pushteti vendor. Volumi i transferitës specifike për ushtrimin e funksioneve të reja mbështetet në të dhëna historike të buxhetit të shtetit mbi shpenzimet që janë kryer nga pushteti qendror për këto funksione. Për rrjedhojë, nuk është kryer asnjë analizë kostoje, si për fondet që duhen për ushtrimin e tyre por edhe për investimet që duhen për t’i ofruar shërbimet plotësisht dhe me standardet ligjore.

⁶ [Shoqata Për Autonominë Vendore](#), [Shoqata e Bashkive të Shqipërisë](#).

3. PROBLEMATIKA TË REFERUARA NGA BIZNESI

Nga konsultimet dhe takimet rajonale të organizuara u evidentuan një sërë problematikash të cilat në mënyrë të përmblodhur janë evidentuar më poshtë:

- » në përgjithësi barra fiskale tatimore në nivel vendor nuk perceptohet e lartë nga biznesi ndonëse në disa raste konsiderohet penalizuese për formalizimin e sektorëve specifikë (si p.sh. për sektorin e turizmit⁷);
- » transparencën e munguar në vendosjen, mbledhjen dhe destinacionin e disa taksave (si p.sh. taksa e përkohshme për infrastrukturën në arsim (Tiranë) dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja);
- » mungesën e kthimit të tarifave dhe taksave në formën e shërbimeve të prekshme për tat. (p.sh.: biznese të cilat edhe pse paguajnë tarifën e pastrimit janë të detyruar të përdorin mjetet e tyre për pastrim veçanërisht në zonat industriale);
- » vendosja e tarifave jo proporcionale në raport me shërbimet e ofruara nga bashkitë (si p.sh. tarifrat e ndotjes në mjedis dhe ajo e largimit të mbetjeve);
- » publikimin jo sistematik të VKB;

- » procedurat komplekse për pagimin dhe mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore veçanërisht nga personat juridikë (bllokimi dhe zhblokimi i llogarive bankare);
- » ndryshimet e vazhdueshme të të gjitha ligjeve relevante që përcaktojnë indikatorë sasiorë në llogaritjen e detyrimeve financiare të shoqërive minerare kundrejt autoriteteve qendrore dhe vendore;
- » vendosja e taksave dhe tarifave vendore pa referenca ligjore;
- » problematika në lidhje me zbatimin e taksës së përdorimit të tokës bujqësore;
- » problematika në lidhje me vonesat për pajisje me leje ndërtimi në rastin kur lejet miratohen nga pushteti vendor (si p.sh. për lejet për ndërtimin e kanaleve të ujërave të larta);
- » problematika në zbatimin e taksës mbi pasuritë e paluajtshme jo për subjektet pronare por për subjektet që ushtrojnë aktivitet në bazë të kontratave të qirasë (p.sh. në fushën e hidrokarbureve);
- » problematika në lidhje me vendosjen e gjohave dhe kryerjen e inspektimeve të shpeshta nga ana e inspektoriateve vendore (si p.sh. në rastin e Inspektoriatit për Mbrojtjen nga Zjarri).

⁷ Konsideratë nga bizneset e formalizuara të akomodimit në Bashkinë Tiranë sa i takon taksës së fjetjes në hotel. Kjo nuk lidhet domosdoshmërisht me konsideratën se niveli i kësaj takse është i lartë por sepse taksa mbledhet vetëm tek njësitë akomoduese të formalizuara, ndërkohë që ka shumë subjekte të tjera të cilat nuk paguajnë/fshehin numrin e shtretërve.

⁸ Referuar databazës së Sekretariatit mbi problemet e biznesit në periudhën 2015-2019.

GJETJE KRYESORE

Gjetjet e mëposhtme janë rezultat i kërkimit të Sekretariatit në bashkëpunim me aktorët kryesorë:

1. NJË KUADËR LIGJOR DINAMIK, POR ENDE PERCEPTUAR SI I PAHARMONIZUAR

Kuadri ligjor që rregullon çështjet që lidhen me taksat, tarifat dhe aspektet financiare të njësisë të vetëqeverisjes vendore mbetet mjaft dinamik. Theksojmë, se ky proces i nisur me iniciimin e reformës administrative-territoriale shpesh ka pasur masa dhe ndërhyrje ligjore të posaçme (ad-hoc), të painte-gruara dhe ende të papërfunduara.

Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe Ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” kanë sjellë një standard të ri në parashikimin e rregullave konkrete mbi decentralizimin në përgjithësi dhe atë fiskal në veçanti si edhe të më shumë burimeve të financimit vendor. Megjithatë, disa nga këto parashikime nuk janë harmonizuar siç duhet, nuk zbatohen dhe/ose kundërshtohen apo krijojnë

mbivendosje me ligje të tjera që referojnë taksat dhe tarifat vendore⁹.

⁹ Mungesa e harmonizimit të plotë të ligjeve të reja, nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” me kuadrin ekzistues vjen për disa arsye ku më kryesoret mund të përmenden:

(a) Shtrirja në kohë e procesit ligjbërës dhe mungesa e integritetit të plotë, adekuat dhe në bllok të të gjithë kuadrin ligjor dhe nënligjor që prek vetëqeverisjen vendore dhe reformën e decentralizimit; (b) Arkitektura komplekse të kuadrin ligjor fiskal që referon elemente formalë, materialë, dhe proceduralë të taksave dhe tatimeve vendore në disa ligje njëherësh dhe në një korpus të gjerë të akteve nënligjore. Në një pjesë të madhe të neneve, ka një mbivendosje midis parashikimeve të ligjit 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (të ndryshuar) dhe ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” nisur edhe qëllimi dhe objekti i vetë ligjeve. Kjo mbivendosje e parimeve dhe rregullave për taksat dhe tarifat vendore në dy ligje të ndryshme, është e padobishme dhe e bën shumë të vështirë njohjen dhe zbatimin e legjislacionit nga bizneset (veçanërisht biznesi i vogël), por edhe nga bashkitë. Kjo bëhet akoma më e vështirë në kushtet kur burimet njerëzore për administratën dhe për pjesën më të madhe të biznesit janë të kufizuara dhe kur ndryshimet në legjislacion janë shumë të shpeshta. P.sh. ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” dhe ligji nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” kanë ndryshuar 17 herë.

(c) Procesi konsultues i kufizuar në një kohë të shkurtër dhe jo gjithmonë gjithëpërfshirës në lidhje me ndryshimet që prekin biznesin/bashkitë. Nga disa bashki u ngrit pretendimi se ligji 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” kaloi shpejt dhe koha për të dhënë komente apo sugjerime ishte e pamjaftueshme.

1. Parashikimi në ligjin 9632/2006 për zgjedhjen e agjentit tatimor për mbledhjen e taksës vendore mbi ndërtesat vjen në kundërshtim me parimet e autonomisë vendore.

Parashikimi i ligjit 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar) sipas të cilit agjentët tatimorë të njësisë të vetëqeverisjes vendore për mbledhjen e taksës së ndërtesës duhet të autorizohen nga Këshilli i Ministrave i cili përcakton dhe masën e përfitimit të tyre¹⁰, mendojmë se është në kundërshtim me parashikimet e ligjeve të mësipërme.

Ky parashikim çënon parimet e autonomisë vendore të sanksionuara në nenin 22/1 të ligjit 13/2015 sipas të cilit: “Njësitë e vetëqeverisjes vendore rregullojnë dhe administrojnë ushtrimin e funksioneve të veta në mënyrë të plotë dhe të pavarur” si edhe nenin 4 “Parime të autonomisë fiskale” sipas të cilit: “Njësitë e vetëqeverisjes vendore u garantohet e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur” dhe nenin 12/3 të ligjit 68/2017 sipas të cilit: “Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të hyjnë në marrëveshje me njëra-tjetrën apo me agjentë tatimorë për mbledhjen e të ardhurave vendore me vendim të Këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas një procedure transparente dhe konkurruese”.

¹⁰ Neni 22/5 paragrafi 2 parashikon: “Taksa mbi ndërtesën, sipas dispozitave të këtij ligji, mund të mbledhet nëpërmjet agjentëve të taksave, të cilët kanë shtrirje territoriale, sistem elektronik të bazës së të dhënave e të gjenerimit të detyrimeve dhe që autorizohen me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore. Këshilli i Ministrave përcakton edhe masën e përfitimit të agjentit të autorizuar, mbi të ardhurat e arkëtuara nga taksa e ndërtesave”. Ky parashikim u vendos në Ligjin bazë 9632 me Ligjin nr. 106/2017.

Nisur nga reagimet e disa bashkive, duket se ka një reflektim për të mos cënuar këtë kompetencë të njësisë të vetëqeverisjes vendore për zgjedhjen e agjentëve tatimorë, duke mos u miratuar edhe VKM-të përkatëse. Përgjithësisht nga takimet e kryera nga Sekretariati me bashkitë, rezultoi se agjent tatimor për mbledhjen e taksës së ndërtesës ishte zgjedhur ndërmarrja e UK.

2. Klasifikim i ndryshëm i taksës së kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë.

Kjo taksë sipas ligjit 68/2017¹¹, cilësohet si një taksë kombëtare 97% e së cilës ndahet me njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ndërkohë ligji 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” e konsideron atë taksë si taksë vendore¹², vjelja e së cilës bëhet nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit të taksave, përfitojnë 3 për qind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë në territorin e së cilës ndodhet pasuria.

3. Mospërputhje në lidhje me masën e taksës vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura që ndahet me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Kjo taksë sipas ligjit 68/2017¹³, cilësohet si

¹¹ Neni 25 “Të ardhurat nga taksat e ndara” paragrafi 2: “Taksat kombëtare që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes vendore janë a) 97 për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë”

¹² “Llojet e taksave vendore” paragrafi 5: Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

¹³ Neni 25 “Të ardhurat nga taksat e ndara” paragrafi 2: “Taksat kombëtare që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes

një taksë kombëtare 25% e së cilës ndahet me njësitë e vetëqeverisjes vendore, ndërkohë që sipas ligjit 9975 datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” (i ndryshuar) parashikohet se vetëm 18% e kësaj takse i kalojnë buxhetit të vetëqeverisjes vendore. Vetëm pas 3 vitesh dhe konkretisht me ligjin nr. 86/2019, datë 18.12.2019¹⁴ u zgjidh kjo paqartësi midis 2 ligjeve duke sanksionuar përfundimisht shifrën 25%.

4. Moszbatimi i detyrimit ligjor për shpërndarjen e 2% të tatimit mbi të ardhurat personale nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

*Ligji 68/2017 në nenin 25 paragrafi ç)¹⁵ i tij parashikon se 2% e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale duhet t'u ndahen njësitë e vetëqeverisjes vendore. Të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës. Pavarësisht se është viti i tretë i zbatimit të ligjit 68/2017, nga konsultimet e Sekretariatit me bashkitë rezulton se ende nuk ka filluar shpërndarja e këtyre të ardhurave dhe rrjedhimisht edhe përmbushja e këtij detyrimi ligjor. **Mangësia teknike mbi mënyrën e ndarjes së TAP tek bashkitë ka ndikuar fondet në dispozicion të bashkive për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi të tyre.***

vendore janë: b) 25 për qind e të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura”

¹⁴ Botuar në Fletoren zyrtare nr. 184, datë 31.12.2019

¹⁵ Taksat kombëtare që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes vendore janë:

ç) 2 për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

2. KUADËR INSTITUCIONAL SFIDUES PËR TË PËRMBUSHUR NË KOHË DHE ME CILËSI REFORMËN

1. Transferimi i përgjegjësi/funksioneve të reja tek bashkitë, në disa raste nuk është mbështetur me ndryshime në kohë dhe të duhura në kuadrin ligjor sektorial, si edhe me një paketë financiare të mjaftueshme. Shembull kryesor janë funksionet e reja që lidhen me administrimin e fondit pyjor dhe kullësor publik, infrastruktura e ujitjes dhe kullimit etj. Kjo u konfirmua gjatë takimeve të Sekretariatit me Bashkitë Tiranë, Korçë, Elbasan dhe Shkodër¹⁶.
2. Legjislacioni i ri mbart ende paqartësi për rolin e qarkut, i cili vazhdon të operojë në të njëjtat kompetenca të para reformës administrative-territoriale, përcaktuar në Ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Funksionet e qarkut janë: a) ndërtimi e zbatimi i politikave rajonale, b) harmonizimi i tyre me politikat shtetërore, në nivel qarku, si dhe çdo funksion tjetër i dhënë me ligj. Këto kompetenca konsiderohen tepër të përgjithshme dhe e kanë tkurrur rolin e qarqeve sikurse konfirmohet edhe nga aktorët e konsultuar.
3. Këshilli Konsultativ për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore duke qenë organ konsultativ konsiderohet se nuk ka patur ndonjë impakt në vendimmarrjen efektive në favor të shqetësimeve të bashkive. Për shembull, në rastin e diskutimeve dhe konsultimeve për metodologjinë e taksës së ndërtesës, këto konsultime janë zhvilluar në një kohë kur projekt-ligji përkatës¹⁷ për ndryshime në taksën e ndërtesës kishte kaluar më parë për miratim në Kuvend.

¹⁶ Është analizuar më në detaje edhe në Raport Auditimin e Performancës “Funksionimi i Bashkive në Kuadër të Reformës Administrative-Territoriale” të KLSH.

¹⁷ Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006

3. TRANSPARENCA E VENDIMMARRJES NGA BASHKITË

1. **Publikimi jo i konsoliduar dhe sistematik i Vendimeve të Këshillave Bashkiakë influencon nivelin e aksesit dhe kufizon transparencën mbi vendimmarrjen e këtyre këshillave dhe të njohjes së tyre nga bizneset.**

Kjo është konfirmuar nga bizneset në Anketën e Sekretariatit (2019) kur janë pyetur në lidhje me nivelin e informacionit që ata kanë mbi vendimmarrjet dhe VKB-të e miratuara prej Këshillave Bashkiakë ku rreth 88% e bizneseve janë shprehur se bashkia nuk i informon në lidhje me VKB-të e miratuara.

- » Në kuadër të Reformës Territoriale dhe Administrative është miratuar platforma online Vendime.al, e cila përbën platformën e publikimit të VKB-ve;
- » Rezulton se disa prej KB, kanë publikuar vendimet në faqet e tyre në internet, ndërsa të tjerë japin si referencë platformën Vendime.al;
- » Në praktikë janë evidentuar raste të VKB të publikuar pjesërisht: Bashkia Vorë, Bashkia Elbasan - publikim i pjesshëm i VKB-ve pa anekset përkatëse të cilat përmbajnë vlerat konkrete të taksave dhe tarifave si në faqet zyrtare në internet të këtyre institucioneve ashtu edhe në platformën Vendime.al. (Ref. VKB Vorë nr. 75 datë 26.02.2017, VKB Vorë nr. 36 datë 23.04.2018 dhe VKB Elbasan nr. 129 datë 20.11.2017).

Burimi: AmCham

2. **Praktika e miratimit të ndryshimeve të përvitshme të VKB në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore në dokumenta të ndryshëm dhe jo të integruar e bën të vështirë gjetjen e informacionit të saktë dhe të përditësuar nga ana e bizneseve.**

Konkretisht, në rastin e Bashkisë Tiranë, VKB nr. 59 datë 30.12.2015 “Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore” është ndryshuar 10 herë me VKB të ndryshme. Këto vendime mund të gjenden të publikuara vetëm të ndara dhe jo të integruara në VKB-në bazë nr. 59/2015 duke e bërë të vështirë përditësimin e bizneseve me detyrimet më të fundit në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore në fuqi. Kjo bëhet akoma më e vështirë kur informacioni publikohet në mënyrë jo sistematike në faqe të ndryshme interneti si p.sh. Bashkia Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë¹⁸ dhe në asnjë platformë nuk gjendet një version i konsoliduar dhe lehtësisht i aksesueshëm. Sa më lartë është evidentuar edhe nga AmCham, si më poshtë detajuar:

VKB-të ndryshohen në mënyrë të vazhdueshme dhe një pjesë e Bashkive edhe nëse i publikojnë vendimet e miratuara, i publikojnë në mënyrë të shpërndarë:

- a. VKB Tiranë nr. 59 datë 30.12.2015, për taksat vendore është ndryshuar disa herë gjatë viteve 2015-2018 që prej kohës së miratimit fillestar;
- b. VKB Vorë nr. 36 datë 23.04.2018 që

¹⁸ <https://www.tirana.al/>, <https://dptv.gov.al/>; <http://www.vendime.al/>

ndryshon VKB nr. 75 datë 26.02.2017 për sistemin e taksave dhe tarifave vendore është publikuar i pjesshëm, ndërsa VKB 75 nuk është publikuar fare në faqen e Bashkisë Vorë, por vetëm në platformën Vendime.al. Kjo mënyrë e pjesshme dhe e shpërndarë qoftë në dokumenta të ndryshëm, apo në faqe interneti të ndryshme të VKB e bën informacionin për taksat dhe tarifat vendore të mos jetë lehtësisht i aksesueshëm, sjell mungesë efience dhe ka kosto kohore duke qenë se kontrollohen faqe të ndryshme interneti dhe dokumenta të ndryshme për të marrë informacionin e përditësuar.

Burimi: AmCham

Ndërkohë, ka bashki të tjera që ndjekin praktika më të thjeshta dhe më efikase në rastin e miratimit vjetor të taksave dhe tarifave vjetore si p.sh. Bashkia Korçë, Bashkia Fier, të cilat duke miratuar paketat fiskale vjetore, shfuqizojnë VKB-të e mëparshme duke integruar të gjitha ndryshimet në një VKB të vetme. Thëksojme se praktika e ndryshimit të VKB-ve bazë me disa ndryshime në vazhdimësi, megjithëse nga ana e teknikës juridike mund të jetë e drejtë, shpesh nuk konsiderohet si më e mira në këndvështrimin e transparencës që duhet të ofrohet për qytetarët dhe bizneset në lidhje me taksat dhe tarifat vendore të cilat kanë shumë kategori, ndarje dhe përjashtime.

3. Vlerësohet roli aktiv i bashkive (p.sh. Tirana, Shkodra) për përshtatjen e procedurave të ankimimit administrativ, por bizneset mbeten ende të paqartë.

Gjatë takimeve të kryera nga Sekretariati, subjektet raportuan se nuk kishin informacion të plotë në lidhje me procedurat që duhet të ndiqeshin në lidhje me ankimimin e taksave dhe tarifave vendore duke pretenduar se informacioni mungon, apo nuk është i aksesueshëm dhe i publikuar për ta. Edhe nëse ankimimi ekziston si procedurë, besimi i tyre për shqyrtimin e ankimimit në mënyrë të paanshme nga bashkia apo në favor të tyre ishte i ulët.

Nga verifikimi i kryer nga Sekretariati në lidhje me sa më sipër rezultoi se është e vërtetë se aksesimi i informacionit në lidhje me procedurat e ankimimit administrativ në strukturat e njësive të vetëqeverisjes vendore është i vështirë¹⁹. Gjithashtu evidentohet se mundësia e apelimit të akteve vendore të bashkive nuk është e shprehur në VKB-në specifike që lidhet me taksat dhe tarifat vendore (p.sh. në VKB nr. 15 datë 30.12.2015 KB Tiranë). Pavarësisht nga sa më sipër, duhet nënvizuar roli aktiv që kanë patur bashkitë për t'iu përshtatur ndryshimeve ligjore në lidhje me miratimin e procedurave, kriterëve dhe ngritjen e strukturave të brendshme kolegjiale në lidhje me apelimin tatimor. Konstatohet se në bazë të ndryshimeve ligjore që pësoi Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar) në fund të vitit 2017²⁰ në

¹⁹ Nga kërkimet e Sekretariatit u evidentua se bashkitë janë asistuar në ngritjen e këtyre strukturave me anë të një Udhërrëfyesi për Hartimin e Rregullores së Organizimit dhe Funkcionimit të Strukturës Vendore të Apelimit Tatimor nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të përgatitur në maj 2018 nga USAID. Përsa i përket vendimarrjes, paanshmërisë apo efikasitetit të këtyre strukturave, Sekretariati ishte në pamundësi për të përgatitur një analizë, pasi informacioni mbi vendimarrjen e këtyre strukturave nuk ishte publik dhe i aksesueshëm, në ndonjë rast nuk disponohej në mënyrë sistematike nga bashkitë (p.sh. Bashkia Elbasan) apo nuk u paraqit informacioni (p.sh. Bashkia Tiranë).

²⁰ Ligji nr. 106/2017, datë 30.11.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 222, datë 19.12.2017

nenin 7 të tij parashikohet se: *Ankimi i taksapaguesit në nivel vendor, kundër vendimit apo veprimit të zyrës së taksave, bëhet tek struktura vendore e apelimit tatimor, sipas kriterëve dhe rregullave të vendosura nga këshilli bashkiak, në përputhje me nenin 4 të këtij ligji. Taksapaguesi ka të drejtë të ankohet në gjykatë kundër vendimit të strukturës së apelimit tatimor në bashki.*

Në bazë të këtij parashikimi rezultoi se të paktën në rastin e Bashkisë Tiranë dhe Bashkisë Shkodër, të verifikuara nga Sekretariati, janë marrë masa për miratimin e VKB-ve përkatëse dhe të dedikuara që adresojnë ngritjen e komisioneve të apelimit tatimor dhe miratimin e rregullores për funksionimin e tyre. Konkretisht në rastin e Bashkisë Tiranë është miratuar VKB nr. 158 datë 21.12.2018 dhe në rastin e Bashkisë Shkodër është miratuar VKB nr. 56 datë 19.07.2018. Informacioni mbi të drejtën e ankimimit në mënyrë të përgjithshme jepet edhe në fund të Njoftimit të Detyrimit Tatimor.

4. Mungesa e një adresari të plotë ndikon në njoftimin jo të duhur të subjekteve në lidhje me njoftimet për detyrimet tatimore.

Kryesisht për Bashkinë Tiranë, pasi në bashki të tjera ky problem është në një shkallë më të vogël, për shkak të numrit më të vogël të bizneseve dhe hapësirës më të kufizuar territoriale. Sekretariati, evidentoi se përgjithësisht njoftimet për vlerësimin e detyrimeve janë konform legjislacionit mbi taksat dhe tarifat

vendore. Nga subjektet u sugjerua përdorimi i mjeteve të reja dhe alternative të ndërveprimit me bizneset, kryesisht nëpërmjet shërbimeve elektronike të tatimpaguesve të cilat do të mundësonin njoftimin në kohë të detyrimeve dhe reduktimin e kostove të dyanshme operative që lidhen me njoftimin (letër, shërbime postare, etj.). Do të vlerësonim hapjen e një debati në lidhje me informimin e subjekteve me instrumenta alternative si p.sh. posta elektronike, etj., duke mos kërkuar mundësisht ndryshime ligjore.

5. Bizneset sipas anketës së Sekretariatit perceptojnë një nivel të ulët të përputhshmërisë së VKB-ve me kuadrin ligjor.

Pyetjes së anketës "A i vlerësoni si të pajtueshme me legjislacionin në fuqi VKB?", 60% e bizneseve të anketuar në rang kombëtar u përgjigjën se VKB-të i konsideronin pjesërisht ose aspak të pajtueshme me legjislacionin në fuqi dhe përgjithësisht perceptimi është i njëjtë në të gjithë qarqet e vendit, ku më shumë se gjysma e bizneseve i konsiderojnë pjesërisht ose aspak të pajtueshme me legjislacionin në fuqi.

Sekretariati gjatë analizës për përputhshmërinë e VKB-ve me ligjet e tjera dhe nga takimet e kryera me aktorët, nuk evidentoi ndonjë rast të VKB-ve në kundërshtim të hapur me ligjin. Sipas bashkive të kontaktuara, VKB-të i nënshtrohen filtrave kontrollues nga KB dhe nga prefektët. Perceptimi i lartë sipas Anketës në lidhje me mospajtueshmërinë e VKB, mund të lidhet me faktin që bizneset e perceptojnë jotransparente dhe të mbyllur vendimarrjen e KB.

6. **Biznesi percepton se ka një diferencim jo-proporcional në përcaktimin e tarifave vendore p.sh. tarifa e pastrimit, etj.**

Në konsultimet direkte të Sekretariatit me bizneset, rezultoi se një problematikë e qenësishme për ta është edhe tarifimi i diferencuar i bizneseve të ngjashme për të njëjtin shërbim.

Nga praktika është evidentuar një dallim i ndjeshëm ndërmjet tarifave të vendosura në bashki të ndryshme. Për shembull, tarifa e pastrimit e vendosur nga VKB Shkodër nr. 63 datë 30.10.2017 është 13.000 lekë për biznesin e vogël dhe 33.000 lekë për biznesin e madh. Ndërkohë që VKB Durrës nr. 401, datë 23.01.2017 përcakton tarifën e pastrimit në nivelin 10.000 lekë për biznesin e vogël dhe 20.000 lekë për biznesin e madh.

Gjithashtu është evidentuar se brenda së njëjtës bashki, e njëjta tarifë ndryshon për taksapagues të kategorive të ngjashme dhe është e paqartë arsyeja e këtij diferencimi (duke vjelë shumicën e taksës nga një subjekt i vetëm).

Paketa fiskale 2018 Bashkia Krujë **Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave**

Për fabrikat e prodhimit të çimentos ekzistuese – 5 000 000 lekë

Për fabrika të tjera, uzinat sipas vendndodhjes së volumit të punës që kryejnë, e të ngjashme – 3 000 000 lekë

Tarifa e gjelbërimit

Për subjektet e tjera Tatimpagues të mëdhenj – 100 000 lekë

Për subjekte të prodhimit të çimentos e të ngjashme me to – 3 000 000 lekë

Burimi: AmCham

Përveç sa më sipër, konstatohet se tarifa e aplikimit për leje ndërtimi në platformën e-Leje nga bashki të ndryshme është e ndryshme. Disa bashki zbatojnë një tarifë standarde (p.sh. 2.500 ALL në Shkodër, në Korçë sipas disa kategorive por jo më shumë se 2.000 ALL), ndërsa Bashkia të tjera e kanë vendosur tarifën për shqyrtimin e aplikimit për leje ndërtimi në platformën e-Leje, duke marrë për bazë vlerën e investimit (p.sh. Bashkia Tiranë aplikon një tarifë 1% mbi vlerën e investimit). Është e vërtetë që Bashkitë kanë autonominë për të vendosur në lidhje me taksat dhe tarifat vendore nëpërmjet vendimmarrjes përkatëse të Këshillave Bashkiake, por në kushtet kur shërbimi i ofruar nëpërmjet platformës është në thelb i njëjtë pavarësisht vendndodhjes së investitorit, vendosja e tarifave të aplikimit si më sipër mendojmë se është joproporcionale dhe objekt debati.

7. **Dokumentacioni për regjistrim pranë Bashkisë Tiranë për pagesën e taksave vendore shpesh konsiderohet si burokratik dhe jo efikas.**

Ngritur nga AmCham në lidhje me rastet e mëposhtme:

Nga sektori i Asistencës dhe Regjistrimit të Tatimpaguesve kërkohet që përpara se të bëhet ndonjë kërkesë/ankesë të paraqiten një sërë dokumentash:

1. *Kjo procedurë bie në kundërshtim me Ligjin "Për Procedurat Tatimore" dhe të gjitha parimet e sanksionuara në të për të drejtat e tatimpaguesve. Për më tepër në lidhje me tatimpagues si persona juridikë, të dhënat që kërkohen lidhen me administratorin si individ. Për t'i bërë edhe më të pakuptimtë këto kërkesa, shumica e dokumentave janë/lëshohen nga organe në varësi të bashkisë. Për çfarë duhet certifikata familjare e administratorit për të regjistruar një biznes? Kuptojmë se kjo procedurë ka për qëllim mbledhjen e taksave për të cilët përgjegjës janë individët, por masat për mbledhjen me formë të detyrimeve tatimore përcaktohen në Ligjin "Për Procedurat Tatimore" dhe në asnjë prej tyre nuk përmendet heqja e të drejtës për t'u ankuar/kërkuar në administratën e bashkisë.*
2. *Nga DPTTV në momentin e paraqitjes së një biznesi të ri për pagesën e detyrimeve tatimore i kërkohet dokumentacioni "Për regjistrimin e biznesit të ri". Si edhe në rastin e mësipërm, dokumentat e kërkuara janë në regjistrat shtetërore me një ndalesë si QKB dhe të vetë bashkisë dhe përveç shpërdorimit të letrës nuk mendojmë se ka ndonjë përfitim për bashkinë duke krijuar procedura totalisht të panevojshme dhe në shkelje të ligjit.*

Burimi: AmCham

8. **Kontributi i biznesit mbetet modest ndonëse procedura e konsultimit të bashkisë mbi vendimet/buxhetin (buxheti i komunitet) kryhet, të paktën në bashkitë kryesore.**

Nga konsultimet e Sekretariatit me biznesin, rezultoi se pjesëmarrja e biznesit në konsultim mbetet e limituar në lidhje me a) taksat e përkohshme dhe tarifat e vendosura nga ana e KB, b) mënyrën e përdorimit të këtyre fondeve në momentin e hartimit të buxheteve vendore. Rritja e besimit ndaj procesit, kushtëzohet edhe me marrjen parasysh ose jo (apo edhe argumentimin nëse nuk merrën parasysh) të kërkesave si gjatë hartimit të paketave fiskale ashtu edhe gjatë ndarjes së burimeve financiare sipas programeve buxhetore.

Theksojmë se Ligji 68/2017, solli risi buxhetimin e pushtetit vendor edhe nëpërmjet konsultimit me grupet e interesit si dhe ka parashikuar vendosjen e gjohave për drejtuesit e bashkive nëse ata nuk zhvillojnë konsultimet e parashikuara. Ndoshta kjo është arsyeja, që publikimi për konsultim është integruar tashmë në punën e bashkive.

Pavarësisht se taksat e përkohshme dhe tarifat vendore paguhen, biznesi nuk është i bindur plotësisht se këto fonde përdoren për destinacionin e deklaruar.

- a) Gjatë konsultimeve të Sekretariatit me biznesin, u theksua niveli i ulët i transparencës së bashkive në lidhje me përdorimin e taksave dhe tarifave të paguara nga biznesi. Për shembull, subjektet në qarkun e Tiranës kërkuar transparencë mbi përdorimin (destinacionin) e fondeve të mbledhura nga Bashkia e Tiranës me taksën e përkohshme për infrastrukturën arsimore apo edhe me taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja.
- b) Proporcionaliteti dhe ligjshmëria e kohëzgjatjes së taksës për infrastrukturën në arsim. Evidentohet se taksa për infrastrukturën arsimore është e vetmja taksa me karakter të përkohshëm, që është parashikuar si e tillë nga

Bashkia Tiranë dhe për një afat 7 vjeçar. Detyrimi vjetor për taksën për infrastrukturën arsimore është parashikuar në VKB nr. 59 datë 30.12.2015 “Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Qytetin e Tiranës”, në pikën 1.f, mbi bazën e parashikimit ligjor të nenit 9 të Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (të ndryshuar). *Ky nen, përveçse parashikon se taksat e përkohshme është një nga kategoritë e taksave vendore, nuk vendos ndonjë kusht apo kriter në lidhje me proporcionalitetin dhe kohëzgjatjen e tyre*²¹.

Një shqetësim tjetër në lidhje me taksën për infrastrukturën arsimore lidhet me zbatimin e saj jo në nivel kompanie/subjekti tatimpagues, por për çdo NUIS sekondar apo vend të ushtrimit të aktivitetit të subjektit. Thëksojmë, se nga kërkimet e Sekretariatit, në portalin open.data.

21 Nisur nga ky boshllëk ligjor që linte një diskrecion shumë të gjerë për bashkitë në vendosjen e taksave të përkohshme, shumë, numrin apo kohëzgjatjen e tyre, me ligjin më të ri nr. 66/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, u bënë rregullimet e duhura. Konkretisht, në përmbajtje të ligjit u parashikua një dispozitë ligjore e posaçme, neni 13 “Rregulla për vendosjen e taksave të përkohshme vendore”. Në këtë nën midis të tjerave në paragrafin 2 përcaktohet se: “2. Vendosja e taksës së përkohshme paraprihet nga hartimi i planit, që përmban, të paktën: a) përcaktimin e shërbimit apo investimit specifik që financohet nga taksat e përkohshme; b) kohëzgjatjen e taksës së përkohshme, e cila nuk mund të zbatohet për më shumë se tre vjet nga hyrja në fuqi, dhe shumën totale e vjetore të të ardhurave që pritet të mblihen; c) koston dhe afatet e kryerjes së shërbimit e investimit, përfshirë pjesën që financohet nga taksat e përkohshme dhe nga burime të tjera, përfshirë edhe pjesën e financimit nga buxheti i bashkisë”, ndërsa në paragrafin 9 përcakton se: “9. Njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk mund të aplikojnë më shumë se dy taksat e përkohshme gjatë një viti buxhetor.” Këto parashikime të mësipërme ligjore adresojnë në një masë të kënaqshme aspektet që lidhen me qëllimet e taksave të përkohshme dhe kohëzgjatjen e tyre. Pavarësisht kësaj, Ligji 66/2017 nuk adresoi në mënyrë proporcionale kohëzgjatjen e taksës së përkohshme dhe konkrete siç është ajo e vendosur nga Bashkia Tiranë, e cila edhe pse e vendosur që në vitin 2015 është ende në fuqi. Kjo sepse me një dispozitë kalimtare dhe konkretisht me nenin 63 të Ligjit nr.66/2017 është parashikuar se taksat e përkohshme të vendosura në fuqi përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatohen në përputhje me legjislacionin në fuqi në kohën e miratimit të tyre.

al për Bashkinë Tiranë²², mund të gjenden informacione të detajuara në lidhje me taksën e përkohshme për arsimin. Konkretisht, nga 2016 deri në vitin 2018, janë mbledhur rreth 1,9 miliardë lekë²³ por Sekretariati nuk gjeti ndonjë informacion të detajuar në lidhje me përdorimin e këtij fondi nga ana e Bashkisë Tiranë.

9. **Biznesi konfirmon se është i informuar në përgjithësi mbi taksat e tarifën që paguan, por është i paqartë në lidhje me mënyrën e llogaritjes së tyre, gjë që mund të jetë rrjedhojë e mungesës së informacionit dhe edukimit të vazhdueshëm fiskal.**

Kjo konfirmohet edhe nga rezultatet e anketës së Sekretariatit ku 48% e bizneseve në rang kombëtar deklarojnë se janë të painformuar në lidhje me mënyrën e llogaritjes së detyrimeve tatimore vendore.

Gjithashtu edhe nga konsultimet direkte me biznesin u vu re mungesa e informacionit në lidhje me detyrimet fiskale vendore, ku një pjesë e tyre deklaruan se ishin shumë të paqartë në lidhje me atë që paguanin. Pavarësisht se pesha e detyrimeve fiskale vendore, në totalin e detyrimeve të tyre fiskale ishte e vogël dhe nuk konsiderohej një problem i qenësishëm, llogaritja e tyre dhe sidomos ana procedurale e kontestimit/apelimit të taksave apo tarifave fiskale vendore si edhe gjobave vendore ishte shumë e paqartë dhe në një masë të madhe nga bizneset konsiderohej si një barrë e rëndë.

22 <https://opendata.tirana.al/>

23 <https://opendata.tirana.al/?q=dataset/planifikimi-dhe-realizimi-i-t%C3%AB-ardhurave-t%C3%AB-bashkis%C3%AB/resource/dbfafa76-f87f-406d-9690>

Bazuar në Ligjin 68/2017, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të vendosin tarifa vendore për një shërbim që këto njësi ofrojnë apo për një të drejtë që u jepet individëve, personave fizikë dhe/ose juridikë. Niveli i tarifës orientohet në mbulimin e koston së shërbimit publik të ofruar nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Nga konsultimet me biznesin rezultoi se ka kontestime të shumta në lidhje me vlerën e tarifave apo edhe mbi shpërndarjen e barrës fiskale mes konsumatorëve familjarë dhe bizneseve. Tarifa më e kontestuar është ajo e pastrimit, për të cilën pretendimet janë se është e lartë kundrejt cilësisë së shërbimit të ofruar (*Amcham, DIHA*).

VKB mbi paketat fiskale të publikuara, në asnjë nga bashkitë nuk kanë të sqaruar metodologjinë e vendosjes së këtyre tarifave e cila mendohet të jetë një mangësi që krijon edhe keqkuptimet mes bashkive dhe taksapaguesve. Për shembull, KM ka miratuar me VKM 319/2018, një Udhëzues për llogaritjen e koston për menaxhimin e mbetjeve i cili do të merret për bazë nga NJVQV gjatë llogaritjes së tarifës së pastrimit. Nëse, p.sh. Bashkia Tiranë e ka marrë parasysh apo jo këtë VKM, kjo nuk bëhet e ditur (të paktën referuar VKB mbi paketën fiskale vendore).

Pra, rritja e transparencës, konsultimit dhe bashkëpunimit real në vendosjen e tarifave nga ana e bashkive me biznesin, por edhe me individët do të shërbente në një masë të konsiderueshme në ndërgjegjësimin e tyre për vlerën, por sidomos edhe mbi pagesën e detyrimeve fiskale vendore.

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave.

Kjo tarifë ka pësuar një rritje të ndjeshme dhe si e tillë është bërë kosto e konsiderueshme për bizneset. Nisur nga kjo dhe faktin që kjo tarifë jepet në këmbim të një

shërbimi është e rëndësishme që të ketë një lidhje sa më të drejtpërdrejtë midis tyre. Konkretisht nivelet treguese dhe tabela e tarifave duhet të rikonceptohen.

Metodologjia e tarifimit dhe transparencja.

A ka bashkia metodologji për ndarjen e barrës tatimore nëpërmjet bizneseve dhe familjarëve lidhur me tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave dhe të taksës së infrastrukturës arsimore? Nëse po, sa përqind e të ardhurave duhet teorikisht të paguhet nga bizneset dhe sa nga individët? Po në realitet çfarë ndodh? Sa përqind e shumës mblihet/arkëtohet nga familjarët?

Burimi: AmCham

10. **Zbatimi i procedurave jo të qarta nga ana e bashkive të cilat dëmtojnë klimën e biznesit dhe raportet e bashkëpunimit bashki-biznes**

a) Procedurat e bllokimit dhe zhblokimit të llogarive bankare nga Drejtoritë Vendore të Tatim-Taksave janë të pakoordinuara dhe krijojnë konflikt me klientët/bizneset të cilët në shumë raste nuk njoftohen paraprakisht nga organet tatimore për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve tatimore. Rikoncilimi i llogarive dhe pagesave si edhe urdhërat e zhblokimit nuk dërgohen në kohë reale pranë bankave të nivelit të dytë.

Një situatë problematike në lidhje me procedurat e ndërmarra nga bashkitë për mbledhjen e detyrimeve tatimore evidentohet edhe nga AmCham:

Në praktikë hasen problematika të mëdha lidhur me urdhërat e bllokimit të dërguara nga bashkitë për mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore nga tatimpaguesit. Kjo vjen fillimisht për shkak se dispozitat e ligjit dhe udhëzimit përkatës “Për Procedurat Tatimore” janë të paqarta dhe me afate të papërcaktuara qartë. Gjithsesi, ajo që vihet re në praktikë është fakti që bashkitë lëshojnë urdhër bllokimi për llogaritë personale të administratorit të subjektit në të njëjtën kohë me urdhërin për bllokimin e llogarisë bankare të vetë subjektit. Detyrimi tatimor i subjektit kalon tek administratori ose ortakut i vetëm në kushte të caktuara dhe asnjëherë pa një vendim gjykatë që njëhënjë përgjegjësinë personale të administratorit/ortakut. Këto veprime çojnë në paligjshmëri të akteve të Bashkisë dhe vendosin bankat në një pozicion të vështirë ku do të duhet të zgjedhin ndërmjet zbatimit të një akti të paligjshëm (përndryshe është subjekt i sanksioneve me gjobë nga bashkia) apo mbrojtjes së interesit të ligjshëm të klientëve të tyre.

Burimi: AmCham

- b) Zbatimi i detyrimeve tatimore edhe për shoqëritë në fazë likuidimi.

Kemi patur shumë subjekte që kanë qenë prej vitesh në status pasiv (në këto raste bashkia nuk vendos detyrime tatimore). Në momentin që hap procedurat e likuidimit, subjekti kalon në status aktiv nga ana e QKB dhe në këtë rast, për të gjithë periudhën që zgjat procedura e likuidimit, bashkia llogarit detyrime për taksat dhe tarifën vendore.

Në këto raste, aktivizimi i statusit në aktiv ka për qëllime vetëm likuidimin e subjektit tatimpagues dhe jo domosdoshmërisht se

ky subjekt ushtron aktivitet ekonomik. Nuk duhet të aplikohen taksa dhe tarifa vendore përveçse kur vërtetohet se subjekti po zhvillon aktivitet ekonomik.

Burimi: AmCham

11. Renta minerare²⁴ - bashkitë

përfutuese të rentës mbeten edhe bashkitë me të ardhura më të ulta dhe në zonat më të varfëra të vendit

Në 45 bashkitë²⁵ në vend shfrytëzohen burimet natyrore dhe ato janë përfutuese të rentës. Nga konsultimet me bashkitë, rezultoi se në përgjithësi, pushteti qendror e transferon shumën e rentës në buxhetet e bashkive, e cila përdoret për investime për njësitë e qeverisjes vendore. Por ende mbetet problematike, vlera e rentës transferuar bashkive duke ngritur çështjen e rishikimit të formulës së shpërndarjes së Rentës Minerare, thjeshtëzimin e procedurave të derdhjes së të ardhurave nga Renta në NjVQV, si dhe problematika të rakordimit të vlerave të përfutura nga renta me Drejtoritë Rajonale të Tatimeve. Nga një analizë e të dhënave, del se bashkitë përfutuese të

²⁴ Sipas Ligjit 9975/2008 “Për taksat Kombëtare”, çdo person fizik ose juridik, i cili është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë qira për burimet natyrore të nxjerra nga, mbi dhe nën tokën e Republikës së Shqipërisë. Renta minerare llogaritet si një detyrim mujor i tatimpaguesit, në kohën kur ai shet produkte minerale. Në rastin e eksportit të produkteve minerale, qiraja paguhet në kohën kur bëhet deklarata e eksportit. 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria.

²⁵ Berat, Bulqizë, Cërrik, Devoll, Dibër, Dropull, Durrës, Elbasan, Fier, Fushë Arrëz, Gjirokastrë, Has, Himarë, Kavajë, Klos, Kolonjë, Korçë, Krujë, Kuçovë, Kukës, Lezhë, Librazhd, Lushnjë, Malësi e Madhe, Maliq, Mallakastër, Mat, Patos, Peqin, Përmet, Pogradec, Poliçan, Prrenjas, Roskovec, Selenicë, Shijak, Shkodër, Skrapar, Tepelenë, Tiranë, Tropojë, Ura Vajgurore, Vau i Dejës, Vlorë, Vorë.

rentës janë në përgjithësi edhe bashkitë me të ardhura më të ulta dhe në zonat më të varfëra të vendit, të tilla si Kukës, Skrapar, Bulqizë, Klos, Mat, Patos, etj. **Bashkia Bulqizë, si një nga bashkitë ku përqendrohet numri më i madh i licencave minerare dhe si rrjedhojë edhe i aktivitetit shfrytëzues të burimeve, renditet nga fundi i listës së bashkive për nga autonomia financiare e matur si përqindje²⁶ e të ardhurave të veta në totalin e të ardhurave.** A mund të hapim një debat në lidhje me modelin se si këto zona me pasuri të mëdha natyrore, të jenë në të njëjtën kohë edhe modele të një ekosistemi të balancuar zhvillimi ekonomik dhe social?

12. Zbatimi i taksës së ndërtesës sipas metodologjisë së vlerës - sfida për bashkitë

Kuadri ligjor për Kadastrën Fiskale, si regjistri qendror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme që shërben për qëllime të administrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme, u miratua në vitin 2017, si shprehje e vullnetit politik dhe si domosdoshmëri në përmbushje të rekomandimeve të FMN.

Në pamundësi për të patur të dhënat të plota nga regjistri i pasurive të paluajtshme, procesi aktual kërkon një ndërveprim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore si përgjegjëse për të përditësuar të dhënat e Kadastrës Fiskale dhe për të zbatuar në praktikë disa nga detyrimet që lindin për këto njësi.

Aktualisht, taksa mbi ndërtesën zbatohet në vijim të parashikimeve specifike në VKM nr. 132, datë 7.3.2018, në bazë të së cilës është metodologjia për taksimin e ndërtesave mbi bazën e vlerës

²⁶ 5% është niveli i të ardhurave të veta/totalin e të ardhurave vendore

reale dhe jo mbi bazën vetëm të sipërfaqes. Sipas metodologjisë të miratuar synohet zgjerimi i bazës së tatimpaguesve drejt kategorisë familjarë për të cilët metodologjia dhe taksimi ka impakt më të madh në raport me bizneset për të cilët barra nga kjo taksë në mjaft raste ulet.

Të ardhurat nga taksa e ndërtesës përbëjnë zërin kryesor në të ardhurat e bashkive. Konkretisht, ky zë përbën 18% të të ardhurave të veta për të 61-të bashkitë në vend ose 5% e të ardhurave totale që ato kanë në dispozicion.

Nga takimet e Sekretariatit në bashki të ndryshme janë marrë komente për disa kriterë në lidhje me taksimin e ndërtesave të cilat mund të jenë objekt rishikimi ose diskutimi. Konkretisht në Bashkinë Shkodër u ngrit pretendimi se në bazë të metodologjisë janë të detyruar të taksojnë njësoj institucionet e arsimit të lartë jo publik me subjektet që zhvillojnë aktivitet tregtar, ndërsa në Elbasan u ngrit pretendimi që njësitë: dyqane pa aktivitet duhet të taksohen njësoj si njësitë e tjera që zhvillojnë aktivitet tregtar.

Aktualisht rezulton se bashkitë zbatojnë metodologjinë e re të taksimit të ndërtesave sipas të dhënave të tyre dhe jo sipas sistemit të kadastrës fiskale i cili mbetet ende në proces kolaudimi.

4. PRITSHMËRITË E BIZNESIT KUNDREJT CILËSISË SË SHËRBIMEVE TË OFRUARA

Bashkitë ofrojnë rreth 36 shërbime funksionale në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, në fushën e shërbimeve sociale, në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese, në fushën e mbrojtjes së mjedisit, në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit, në fushën e zhvillimit ekonomik vendor, në fushën e sigurisë

publike si edhe funksione dhe kompetenca të deleguara. Ligji 139/2015 shtoi numrin e shërbime për NJVQV, duke kthyer shërbimet e ndara në shërbime ekskluzive të NJVQV, të tilla si edukimi parashkollor dhe parauniversitar, shërbimi i zjarrfikseve, mbrojtja e mjedisit, etj.

a) *Nevojitet vendosja e standardeve kombëtare minimum të vlerësimit të ofrimit të shërbimeve të cilat të jenë të zbatueshme në rang kombëtar dhe lokal.*

Pyetjes së anketës “A e konsideroni të drejtë balancën mes shërbimit të përfutur dhe tarifave vendore që paguani?” 78% e bizneseve i'u përgjigjën se e konsiderojnë pak ose aspak të drejtë këtë balancë.

Nga konsultimet e Sekretariatit me bashkitë dhe subjektet rezultoi se mungojnë standarte të vlerësimit të ofrimit të shërbimeve në nivel lokal. Ndërkohë analiza e dokumenteve të publikuar tregon se ka standard të ofrimit në një pjesë të shërbimeve lokale të tilla si arsimit *parashkollor dhe mbrojtja nga zjarri*, por mungojnë standarde në nivel vlerësimi të shërbimit të ofruar. Në këtë kontekst, do sugjerohej që procesi i vendosjes së standardeve të fillojë në ato shërbime ku standardet ekzistojnë.

Theksojmë se Ligji 139/2015 u kërkon NJVQV të sigurojnë dhënien e shërbimeve publike duke hartuar dhe vendosur në një sistem administrimi të performancës²⁷ së shërbimit, bazuar mbi standarde vendore dhe/ose standarde minimale

27 Vlerësimi PEFA, i bërë mbi disa nga bashkitë e vendit nxori në pah mungesën e objektivave në ofrimin e shërbimeve lokale për të vlerësuar efektivitetin dhe efikasitetin në përdorimin e burimeve. Kjo përforcohet edhe nga auditimi i performancës realizuar nga KLSH në lidhje me cilësinë e disa shërbimeve të ofruar nga bashkitë konkluzioni i të cilës ishte se në nivel vendor mungojnë treguesit e performancës për shërbimet dhe monitorimi i tyre. Mungojnë standarde të qarta kombëtare (rasti i arsimit-mësues për klasë) të shërbimeve publike vendore, gjë që e bën të pakuptimtë çdo sistem të monitorimit dhe vlerësimit të veprimtarisë së pushtetit vendor përsa i përket shpërndarjes së shërbimeve. Edhe në raste kur ka standarde ligjor, si zjarrfikës për mijë banorë, ato nuk po zbatohen.

kombëtare, si edhe hartimin dhe vendosjen e një sistemi treguesish, për matjen e performancës.

b) *Shërbimet Elektronike - Perceptimi nga Anketa dhe raste konkrete.*

Në nivel kombëtar, ofrimi i shërbimeve online për biznesin dhe individin është një nga prioritetet kryesore të axhendës së qeverisë qendrore. Edhe në nivel lokal janë bërë përpjekje, ndonëse të pakoordinuara²⁸, nga ana e bashkive për të mundësuar lehtësi në ofrimin e shërbimeve, kryesisht ato fiskale të përqendruara në ofrimin online të detyrimit të pagimit të taksave dhe tarifave vendore.

Nga anketa e Sekretariatit dhe konsultimet me biznesin rezultoi se:

- » biznesi është i interesuar në minimizimin e kontakteve me punonjësit e bashkive dhe përfitimin e shërbimeve online të cilat u kursejnë kohë dhe ndihmojnë në uljen e korrupsionit.
- » në lidhje me shërbimet elektronike të ofruara nga bashkitë në territorin e të cilave ata ushtronin aktivitetin e tyre, 64% e bizneseve në rang kombëtar u përgjigjën se bashkia nuk u ofron shërbime elektronike ndërsa 12% e tyre u përgjigjën “Nuk e di”.

Në *nivel qarku, Tirana ka perceptimin më pozitiv, ku 34% e bizneseve deklaruan se bashkia iu ofron shërbime elektronike dhe ata përfitojnë prej tyre, në vend të dytë renditet qarku Shkodër ku 15% e bizneseve deklaruar se bashkia u ofron shërbime elektronike të cilat ata i përdorin.* Ndërkohë në qarkun Korçë vetëm 8% e bizneseve iu përgjigjën pozitivisht pyetjes nëse ata përfitonin shërbime elektronike nga bashkia e tyre.

Nga takimet me administratën e bashkive dhe biznesin u konstatuan tre tipologji në lidhje me

28 Bashkitë me anë të donatorëve kanë krijuar programe kompjuterike mbi administrimin fiskal të cilat janë të ndryshme për bashki të ndryshme.

shërbimet elektronike:

(1) *Rasti i Bashkisë Tiranë*

Bashkia Tiranë ofron një sërë shërbimesh për biznesin dhe individët, jo vetëm nëpërmjet faqes së tyre të internetit, por edhe nëpërmjet portalit e-Albania. Gjithashtu DPTTV ka faqen e vet të internetit, ku çdo biznes me anë të llogarisë së tij merr njoftim zyrtar mbi shumën e detyrimeve tatimore vendore, edhe pse përdorimi i tij nga ana e biznesit nuk është shumë i lehtë si p.sh. rasti kur përdoruesi kërkon të ndryshojë fjalëkalimin është e nevojshme që ai të paraqitet pranë sporteleve të DPTTV.

(2) *Rasti i Bashkisë Korçë*

Në Korçë²⁹, pavarësisht se ofrimi i shërbimit online të marrjes së njoftimit mbi detyrimet lokale vendore ekziston, bizneset nuk e përdornin dhe deklarorin se ishin të kënaqur me dërgimin e njoftimit nëpërmjet postës apo edhe me komunikimin direkt me bashkinë.

(3) *Rasti i Bashkisë Shkodër*

Bashkia Shkodër³⁰, ka ndërtuar një sistem të integruar me një ndalesë për regjistrimin dhe shërbimin për taksapaguesit biznes dhe familje, të shpërndarë në gjithë territorin e bashkisë, i cili do të bëhet plotësisht funksional gjatë vitit 2020.

5. ROLI I BASHKIVE NË ZHVILLIMIN EKONOMIK – POLITIKËBËRËS APO VETËM EKZEKUTUES

Nga konsultimet me subjektet rezultoi se perceptimi mbi rolin e bashkive në zhvillimin ekonomik të territorit është modest. Kjo kryesisht mund të jetë rrjedhojë e faktit që NJVQV kanë pak të ardhura në diskrecion të plotë të tyre dhe shumica e burimeve financiare shkon për përballimin e shpenzimeve

operative të bashkisë duke mos u lënë shumë fonde për investime apo ndihmë konkrete drejt biznesit të vogël e të mesëm.

Ligji 139/2015 u ka njohur bashkive si një nga funksionet bazë edhe atë të zhvillimit ekonomik të qytetit, kryesisht në hartimin e planeve strategjike të zhvillimit e të programeve për zhvillimin ekonomik vendor. Ndërkohë, nga konsultimet rezultoi se biznesi në përgjithësi konsideron se bashkitë më shumë i japin prioritet mbledhjes së taksave dhe tarifave sesa mbështetjes dhe promovimit të biznesit.

Kështu p.sh. një burim i konsiderueshëm për bashkitë në 2-3 vitet e fundit dhe që lidhet edhe me rritjen e sektorit të turizmit, janë të ardhurat që merren nga qiratë për kontratat e lidhura me subjektet private për shfrytëzimin e stacioneve të plazhit dhe vendosjen e rregullave për disiplinimin e tyre. Gjatë vitit 2018, Sekretariati ka evidentuar disa probleme të bizneseve në plazhin e Velipojës lidhur me mungesën e transparencës në lidhjen e kontratave të qirasë, kohën e shkurtër të njoftimit për lidhjen e tyre apo afatet e shkurtra kohore prej vetëm 1 viti të kohëzgjatjes së tyre, e cila penalizon investimet apo zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë. Nga konsultimet që patëm në Bashkinë Shkodër, kjo problematikë u konfirmua, por që sipas tyre lidhet edhe me miratimin e vonuar të rregullores³¹ përkatëse për kushtet dhe kriteret e përdorimit të plazheve dhe mungesës së koordinimit institucional, duke nënvizuar edhe problematika që lidhen me informalitetin në plazhe.

Nga verifikimi i kryer nga Sekretariati, rezultoi se rregullorja³² përkatëse u miratua vetëm në

31 VKM nr. 171, datë 27.3.2019 Për Miratimin e Rregullores “Për Kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Stacionit të Plazhit”

32 Megjithatë duket se rregullorja ka vendosur më në fund

29 www.bashkiakorke.gov.al

30 www.bashkiashkoder.gov.al Paketa Fiskale 2020

fund të **muajit mars 2019** dhe ndërkohë kontratat duhet të lidheshin brenda datës 20 prill. Gjithashtu evidentohet mungesa e iniciativave dhe projekteve në nivel qarku për zhvillimin ekonomik të integruar. Roli i vakët i qarqeve në kompetenca dhe në mbështetje financiare të bashkive nuk ka mundësuar ende ndonjë projekt zhvillimi në nivel rajonal. Përpjekja për nxitjen e zhvillimit ekonomik rajonal nëpërmjet krijimit të Agjencisë Kombëtare Për Zhvillimin Rajonal (AKZHR), Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal (AZHER) dhe Agjencive të Zhvillimit Rajonal (AZHR) në vitin 2015 nuk rezultoi efektive. Këto agjenci nga viti 2018 u shkrinë dhe funksionet e tyre i kaluan Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FZHR), i cili është instrumenti kryesor për kryerjen e investimeve³³ por për të përfutur nga ky grant bashkitë duhet të konkurrojnë. Bashkia Korçë, përdor si nxitës për biznesin³⁴ instrumenta fiskale të tillë si, zbatimi i normave më të ulëta të tarifave brenda kufinjve që u lejon legjislacioni në fuqi. Megjithatë, bashkitë nuk kanë shumë instrumenta të cilët mund të përdorin për të shërbyer si nxitës për bizneset. *Ligji u jep të drejtën e mosap-*

baza të qëndrueshme në lidhje me kushtet dhe kriteret për zhvillimin në plazhe, duke mundësuar një parashikueshmëri më të madhe për bizneset dhe bashkitë për zhvillimin vendor. Në rregullore parashikohet se kontratat nga bashkitë mund të lidhen për një afat nga 1 deri në 5 vite dhe në çdo rast ky proces duhet të mbyllet deri më 31 mars të çdo viti/sezoni.

33 Sipas raportit të KLSH, 40% e investimeve nga bashkitë në vitin 2017 janë nga fondet e FZHR dhe në 37/61 bashki investimet e qeverisë qendrore shkojnë deri në 17 herë më të larta se investimet nga fondet e vetë bashkive. http://www.klsh.org.al/web/Raporte_te_Auditimeve_te_Performances_3218_1.php

34 Bashkia Korçë si formë incentivimi për rritjen e punësimit përdor uljen e tarifave ndaj bizneseve sipas skemës: 20% ulje për biznese me më shumë se 20 punonjës, 50% ulje për biznese me më shumë se 50 punonjës, 100% ulje për biznese me më shumë se 100 punonjës, Përfashtim i bizneseve të reja (startup) nga tarifat lokale për 1 vit.

likimit të taksave, por nga asnjë bashki kjo mundësi nuk është marrë parasysh, duke konsideruar nivelin e ulët të të ardhurave të tyre.

Nga ana tjetër kërkohet rritja e kapaciteteve të brendshme të bashkisë/krijimin e njësive të dedikuara për të arritur fondet (partnerët për zhvillim, institucionet financiare dhe jofinanciare, donatorët) dhe burimet e tjera të mjaftueshme për të luajtur rolin efektiv si iniciatorë, katalizatorë dhe nxitës të zhvillimit ekonomik lokal në komunitetet e tyre. Bashkëpunimi me AIDA-n mbetet mjaft i rëndësishëm për të maksimizuar potencialin e tërheqjes së investimeve. Gjithashtu, një mangësi tjetër ka të bëjë edhe me asetet vendore të cilat edhe pse shihen si burim të ardhurash në pjesën më të madhe nuk mund të shfrytëzohen nga bashkitë pasi ose nuk i kanë në zotërim, ose janë asetë në territorin e tyre, por në pronësi të institucioneve qendrore. Pra, **bashkitë e kanë të kufizuar tagrin për të vepruar në territorin e tyre.** Ky është një problem që u ngrit gjatë takimeve të Sekretariatit në Bashkinë Shkodër, **por që ka dalë edhe nga analiza të mëparshme të KI.**

Në këndvështrimin e bizneseve të kontaktuar, bashkitë duhet të jenë **të qëndrueshme në prioritet** dhe vendimmarrjen e tyre, duke mundësuar më mirë zgjidhjen e 2-3 problemeve kyçe duke alokuar menjëherë të gjitha fondet e mjaftueshme, sesa duke bërë investime të pjesshme, zonale dhe të cilat nuk garantojnë qëndrueshmëri. Referencat kryesore në lidhje me këtë aspekt bëhen për investimet në infrastrukturën vendore në zonat industriale si p.sh. nga bizneset në Bashkinë Shkodër, apo edhe bashki të tjera.

Edhe pse bashkitë kanë shumë pak kompetenca në dispozicion të tyre për të ofruar incentiva të prekshme për bizneset në territorin e tyre, në përg-

jithësi bashkitë zgjedhin të vendosin minimumin e taksave të parashikuara nga ligjet kuadër, si për shembull, në shumë bashki në të cilat intensiteti i ndërtimit është i ulët është zgjedhur të zbatohet si taksë infrastrukturë në ndërtim minimumi i parashikuar nga Ligji 9632 datë 30.10.2006, prej 4% të vlerës së investimit (Bashkitë Shkodër, Korçë, etj.)

TEDA – Projekti i Bashkisë Tiranë si mundësi reale për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm

BT synon krijimin e një Zone të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA) të standarteve

perëndimore me prioritet industrinë me karakter teknologjik sic janë industria automobile, TIK, dhe elektronike³⁵. Krijimi dhe funksionimi i kësaj Zone (TEDA Kashar), ka si qëllim krijimin e një territori të veçantë me një regjim fiskal dhe doganor tepër lehtësues për ushtrimin e aktivitetit ekonomik dhe që nxit investimet, hapjen e vendeve të punës dhe rritjen e të ardhurave, përshtetimin e zhvillimit rajonal dhe zgjerimin e lidhjeve ekonomike të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar, futjen e teknologjisë së përparuar dhe përshtetimin e qarkullimit të mallrave dhe kapitaleve³⁶.

35 Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022- https://tirana.al/uploads/2019/3/20190304142936_szhqbt-2018-2022-30-e-miratuara-per-eeb-finale.pdf -

36 Greenfield – i personalizuar që në themel. Ndryshe nga zonat e tjera ekonomike në territorin e Shqipërisë, Zona e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA) Kashar është Greenfield, duke krijuar kështu një mundësi për ndërtesa të personalizuar në varësi të kapacitetit specifik të investitorit. Sipërfaqja e përzgjedhur është rreth 50 hektarë, ndërkohë që gjithë sipërfaqja fushore e pandërtuar shkon në 150 hektarë. Infrastrukturë e përshtatur për kapacitetin e nevojshëm. Një faktor specifik që përcakton destinacionin e investimeve është infrastruktura. Zhvilluesi i zonës, në këtë rast BT, është përgjegjëse për vendosjen e infrastrukturës së nevojshme brenda kufijve të zonës së përcaktuar. Duke qenë gjithashtu një projekt me përfitim publik, është detyrë e qeverisë qendrore të pajisë me infrastrukturë pjesën jashtë kufijve të zonës. Një vendndodhje strategjike. Një nga përcaktuesit kryesorë për suksesin e një zone ekonomike është edhe vendndodhja. Tiranë, si kryeqytet i Shqipërisë, është i vendosur në zemër të vendit, dhe është e lidhur strategjikisht me rrjete rugore që e lidhin më së miri me kufijtë e vendit, tregjet rajonale dhe jo vetëm. Janë rreth 3,719 km rrugë, ku rrugët primare kombëtare janë të shtrëna sipas standarteve ndërkombëtare, dhe janë të mirëlidhura logjistikisht me korridorët kryesorë të Evropës Lindore. Krahë pune me potencial të lartë. Zona metropolitane midis dy qyteteve kryesore të Shqipërisë, Tiranës dhe Durrësit, ku TEDA do të implementohet, përfaqëson pothuajse 40% të popullsisë totale, 63% të prodhimit kombëtar dhe 50% të ndërmarrjeve vendase duke krijuar oganikisht një nga cluster-at ekonomik më të rëndësishëm në Shqipëri.

REKOMANDIME

1. LIGJORE

REKOMANDIM 1.

Harmonizimi i legjislacionit në fushën e taksave dhe tarifave vendore me legjislacionin e ri për vetëqeverisjen vendore.

Konkretisht Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar) duhet të harmonizohet me Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe Ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”. Për këtë është e nevojshme:

- Shfuqizimi i nenit 22/5 paragrafi 2 në Ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 me përmbajtje “Taksa mbi ndërtesën, sipas dispozitave të këtij ligji, mund të mbliidhet nëpërmjet agjentëve të taksave, të cilët kanë shtrirje territoriale, sistem elektronik të bazës së të dhënave e të gjenerimit të detyrimeve dhe që autorizohen me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore. Këshilli i Ministrave përcakton edhe masën e përfitimit të

agjentit të autorizuar, mbi të ardhurat e arkëtuara nga taksa e ndërtesave”.

- Saktësimi i kategorisë së taksës së kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë, nëse është taksa kombëtare apo taksa vendore.

Duke u nisur nga ndryshimet e shumta dhe të shpeshta që ka pësuar Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore” duke u ndryshuar në total 17 herë për vetëm 39 nene, në afatgjatë sugjerohet hartimi i një ligji të ri dhe gjithëpërfshirës që të garantojë unitetin e normave juridike dhe koherencën e tyre në një kontekst afatgjatë.

REKOMANDIM 2:

Zbatimi i detyrimit ligjor sipas nenit 25 paragrafi ç) i Ligjit 68/2017 për ndarjen e 2% të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale, njërive të vetëqeverisjes vendore.

Të specifikohet nga MFE formula e ndarjes së këtij tatimi sipas secilës bashki.

2. TRANSPARENCA DHE EDUKIMI FISKAL

REKOMANDIM 3.

Publikimi dhe rritja e transparencës mbi taksat dhe tarifave vendore për biznesin nëpërmjet:

- Njoftimit dhe informimit të taksave dhe tarifave vendore dhe procedurat që lidhen me pagimin e tyre në mjete komunikimi lehtësisht të arritshme: p.sh. njoftime në llogarinë online të taksave dhe tarifave vendore, njoftime me e-mail, faqen e internetit.
- Publikimi i VKB-ve vjetore mbi taksat dhe tarifave në mënyrë të integruar dhe të konsoliduar;
- Marrja e masave nga bashkitë për publikimin në kohë reale të VKB në platformën ekzistuese vendime.al dhe në seksione të dedikuara brenda faqes së tyre të internetit.

REKOMANDIM 4.

Përgatitja, bërja publike dhe lehtësisht e arritshme e një seksioni të dedikuar mbi procedurat e ankimit administrativ në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

- Modelet standarde të Njoftimit të Vlerësimit Tatimor të parashikojnë në mënyrë konkrete: a) të drejtën e tatimpaguesit për ankim; b) mënyrat e ankimit; c) afatin brenda të cili duhet të bëhet ankimi; d) strukturën përgjegjëse për shqyrtimin e ankimit administrativ, e) linkun mbi informacionin e detajuar për të drejtat dhe detyrimet e palëve në një procedurë efektive të ankimit administrativ.
- Struktura e shqyrtimit të Ankimit Administrativ, kompetenca, baza ligjore e funksionimit të saj dhe vendimet përfundimtare mbi ankimet administrative të bëhen publike (duke anonimizuar në këto vendime të dhënat personale), për të mundësuar unifi-

kimin e praktikave dhe transparencën për të gjitha palët e përfshira.

REKOMANDIM 5.

Përgatitja e një Manuali kombëtar për përcaktimin e nivelit të tarifave në rastet kur kjo mungon.

Në hartimin e udhëzimit/metodologjisë si edhe përcaktimin e tarifave, KB përkatës duhet të mbajë parasysh parashikimet e ligjit se tarifa duhet të orientohej drejt mbulimit të kostos së shërbimit të ofruar. Metodologjia nuk duhet të cenojë parimet e autonomisë vendore të parashikuara nga ligji, por duhet të vendosë disa standarde mbi arsyetimin e përcaktimit të nivelit të tarifave dhe mbi arsyetimin e diferencimit ndërmjet taksapaguesve që janë subjekt i niveleve të ndryshme të së njëjtës tarifë. Referencë udhëzimi mbi miratimin e metodologjisë për llogaritjen e tarifës së pastrimit.

REKOMANDIM 6.

Bashkitë të mundësojnë përditësimin në kohë reale të detyrimeve të shlyera dhe/ose të mbartura nga bizneset si dhe informacionin mbi bizneset (administratorin). Kjo do të mundësonte një koordinim më të mirë:

- Në rastet e bllokimit/zhblokimit të llogarive bankare të subjekteve tatimpagues pranë bankave të nivelit të dytë.
- Në rastin e vlerësimit/llogaritjes së taksave dhe tarifave vendore për subjektet tatimpaguese gjatë periudhës së likuidimit.

Në lidhje me sa më sipër sugjerohet krijimi i një ndërfaqeje informative të shkëmbimit të informacionit online mes bashkive dhe bankave të nivelit të dytë. Mjaft i rëndësishëm do ishte edhe unifikimi/standardizimi i formateve elektronike të urdhrave të bllokimit.

REKOMANDIM 7.

Bashkitë të bëjnë transparencë mbi metodologjitë në lidhje me vendosjen dhe llogaritjen e tarifave për shërbimet e ofruara si p.sh. për referencë modeli i ndjekur për vendosjen e tarifës së pastrimit.

3. SHËRBIME**REKOMANDIM 8.**

Zbatimi në praktikë i standardit të shërbimeve: Në koordinim qeveri qendrore-njësi të vetëqeverisjes vendore të mundësohet:

1. Hartimi dhe vendosja e standardeve kombëtare minimale të ofrimit për të gjitha shërbimet e ofruara në nivel lokal;
2. Ngritja e një sistemi për matjen e performancës në nivel bashkie, në lidhje me ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve/biznesit bazuar në indikatorë konkretë.

REKOMANDIM 9.

Dixhitalizimi i shërbimeve administrative në nivel vendor në kuadër të reformës së derregullimit.

1. Dërgimi online i Njoftimeve të Detyrimeve Tatimore Vendore, nëpërmjet sistemit vendor të taksave dhe tarifave vendore që duhet të bëhet i zbatueshëm në të gjitha bashkitë në vend.
2. Të thjeshtohet procedura dhe dokumentacioni që u kërkohet bizneseve për regjistrim në bashki p.sh. lehtësim i barrës së bizneseve për marrjen e dokumentave që mund të shkëmbehen mes vetë zyrave të shtetit.

4. ZHVILLIMI EKONOMIK**REKOMANDIM 10.**

Krijimi i platformave funksionale lokale dhe rajonale të bashkëpunimit për zhvillimin ekonomik në nivel lokal dhe rajonal, me pjesëmarrjen e NJVQV, bizneseve, komunitetit, institucioneve financiare, etj. Për referencë mund të merren modele që janë ngritur si Tauleta në Shkodër dhe Auleda në Vlorë³⁷.

REKOMANDIM 11.

Rritja e transparencës mbi vendimmarrjen e bashkive në lidhje me projektet dhe programet e zhvillimit vendor nëpërmjet publikimit periodik dhe paraprak të tyre, në mënyrë që bizneset të përgatisin në kohë planet e tyre të biznesit. E rëndësishme është që të publikohet në faqet e internetit të bashkive dhe një “pasaportë potenciali për investime” me të dhëna konkrete edhe mbi forcën e punës, edukimin, punësimin dhe të gjithë faktorëve të tjerë që ndikojnë në tërheqjen e investimeve.

REKOMANDIM 12.

Regjistrimi në ASHK *i aseteve/pasurive* të paluajtshme nën administrimin e bashkive. Publikimi i tyre, transparenca mbi statusin e procesit të transferimit dhe regjistrimit të këtyre pronave, si dhe bërja e vlefshme për shfrytëzim në mbështetje të zhvillimit ekonomik e në funksion të krijimit të të ardhurave.

REKOMANDIM 13.

Duhet të përfundohet procesi i nisur tashmë i kalimit të funksioneve të reja tek bashkitë në aspektin e përkufizimit të qartë të tyre dhe të kompetencave mbi to në legjislacion,

REKOMANDIM 15.

Zbatimi dhe intensifikimi i konsultimeve Bashki-Biznese për të trajtuar dhe analizuar zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm.

REKOMANDIM 16.

Ngritje kapacitetesh e Bashkive mbi përgatitjen cilësore të raportimeve financiare në mënyrë periodike dhe bërja e tyre publike. Kjo është një domosdoshmëri për investitorët potencialë, transparencë ndaj komunitetit, do shërbente për të shqyrtuar efikasitetin e punës së secilës bashki dhe do të rriste mundësitë e kreditimit të Bashkive me qëllim rritjen e investimeve dhe zhvillimin ekonomik (EBRD).

si edhe shoqërimi i tyre me paketën e duhur financiare. Këtu mund të përmendet fakti se ushtrimi i këtyre funksioneve nga njësitë vendore është shoqëruar me problematika lidhur me pamjaftueshmërinë financiare për ofrimin e këtyre shërbimeve sipas standarteve të përcaktuara në legjislacionin përkatës (p.sh. Ligji për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi, vendos disa standarte, të cilat janë të pamundura të plotësohen nga bashkitë me fondet e transferuara nga buxheti qendror).

REKOMANDIM 14.

Zbatimi dhe vënia në funksion i *projektit TEDA* në Bashkinë Tiranë dhe replikimi i modelit në rajone/bashki të tjera me plane konkrete të zhvillimit ekonomik.

37 <https://teuleda.org.al> <http://www.auleda.org.al>

SHTOJCË

KONTEKSTI MBI DINAMIKAT FUNKSIONALE, LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

BURIMET FINANCIARE TË BASHKIVE

1. Taksa, tarifa dhe të ardhura të tjera vendore:

a) Taksa Vendore

Taksat vendore janë të vendosura me ligj, ndërkohë Këshilli Bashkiak ka të drejtë të vendosë taksë të përkohshme për ofrimin e shërbimeve dhe të investimeve publike specifike por për një periudhë të caktuar kohore. Taksa Vendore, të vendosura sipas legjislacionit në fuqi:

- » taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen:
 - o taksa mbi ndërtesat,
 - o taksa mbi tokën bujqësore,
 - o taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to;
- » taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
- » taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier;
- » taksa e tabelës;
- » taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj;

- » taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël;
- » taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore;
- » taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

Këshilli i NJVQV ka të drejtë të vendosë taksë të përkohshme për ofrimin e shërbimeve dhe të investimeve publike specifike por për një periudhë të caktuar kohore.

b) Tarifa Vendore

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të vendosin tarifa për një shërbim që këto njësi ofrojnë apo për një të drejtë që u jepet individëve, personave fizikë dhe/ose juridikë dhe niveli i tarifës orientohet në mbulimin e kostos së shërbimit publik të ofruar nga Bashki. **Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore përcakton dhe nivelet e tarifave vendore sipas llojeve të parashikuara në legjislacion.**

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të vendosin tarifa për një shërbim që këto njësi ofrojnë apo për një të drejtë që u jepet individëve, personave fizikë dhe/ose juridikë dhe niveli i tar-

ifës orientohet në mbulimin e kostos së shërbimit publik të ofruar nga NJVQV.

Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore përcakton nivelet e tarifave vendore, llojet e të cilave janë renditur më poshtë:

- » tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave;
- » tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve;
- » tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizimet;
- » tarifa për shërbimin e ujitjes dhe të kullimit;
- » tarifa për shërbimet administrative dhe dhënien e licencave, lejeve e autorizimeve;
- » tarifa të përkohshme, në përputhje me rrethana të përcaktuara në ligj;
- » tarifa të tjera, të përcaktuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- » tarifa të tjera, të përcaktuara në ligj.

c) Të ardhura të tjera. Bashkitë mund të krijojnë të ardhura edhe nga asetet dhe veprimtaritë ekonomike si edhe nga donacionet.

Më poshtë jepen të detajuara Taksa/Tarifa të aplikuar në bashkitë e Tiranës, Shkodrës, Korçës dhe Elbasanit. Burimi i informacionit janë faqet zyrtare të bashkive për taksa dhe tarifa vendore në fuqi deri në fund të vitit 2019.



Taksa dhe Tarifa
Vendore.xls

d) Fondet e transferuara nga buxheti i shtetit

NJVQV marrin nga qeverisja qendrore *transferta të pakushtëzuara* dhe *të kushtëzuara* dhe një pjesë nga *të ardhurat nga taksat kombëtare*. NJVQV kanë autonomi të plotë në përdorimin e transferit të pakushtëzuar dhe të ardhurat nga tatimet dhe taksat e ndara, ndërsa transferata e kushtëzuar përdoret për qëllimin dhe në mënyrën e përcaktuar nga njësi që jep transfertën.

» *Transferta e pakushtëzuar* nga Buxheti i Shte-

tit u jepet NJVQV për financimin e ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj. Shuma totale e transfertës së pakushtëzuar nuk mund të jetë më pak se 1% e PBB vjetore dhe në asnjë rast më e vogël se shuma e një viti më parë. Ndarja e saj sipas bashkive bëhet sipas formulës së miratuar me ligj, duke marrë në konsideratë popullsinë rezidente në territorin e bashkisë, dendësinë e popullsisë në territor si edhe numrin e nxënësve në arsimin parauniversitar.

» *Të ardhurat nga taksat e ndara* NJVQV marrin një përqindje nga taksat ose tatimet kombëtare që realizohen në juridiksionin e tyre, sipas përcaktimeve ligjore. Taksat kombëtare që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes vendore janë:

- o 97 për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë;
- o 25 për qind e të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura;
- o 5 për qind e të ardhurave nga renta minierare;
- o 2 për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale

» *Transferta e kushtëzuar* jepet për:

- o funksione të deleguara NJVQV;
- o projekte të veçanta, të konsideruara me interes vendor, rajonal apo kombëtar, ku kërkohet bashkëpunimi me vetëqeverisjen vendore

» *Transferta specifike* jepet për:

- o financimin e funksioneve të reja të transferuara te NJVQV
- o financimin e shërbimeve në raste të emergjencave apo situatave të ngjashme me interes kombëtar, ku kërkohet bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore

e) **Huamarrija Vendore**

Bashkitë kanë të drejtë të marrin hua afatshkurtër dhe afatgjatë sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.


2. Burimet në dispozicion të qeverisjes vendore në përmirësim por ende të pamjaftueshme

Miratimi i ligjit të ri mbi financat e vetëqeverisjes vendore, forcoi rregullat e buxhetimit dhe disiplinës fiskale në nivel vendor. **Rritja e parashikueshmërisë dhe transparencës mbi fondet e përfituara nga buxheti i shtetit si edhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, krijuan një mundësi më të madhe për bashkitë në përgatitjen e buxheteve më realiste dhe më eficiente.** Lidhja e transfertës së pakushtëzuar të përfitur nga bashkitë me PBB-në rriti fondet në dispozicion të bashkive duke bërë që transfertat e pakushtëzuar të shpërndarë në vitin 2019 të jetë 42% më e lartë se vitin 2015 para miratimit të ligjit dhe rreth 38% më e lartë se niveli historik.

ik i saj. Gjithashtu transferimi i funksioneve të reja bashkive u shoqërua me fonde financiare në mbështetje të tyre, edhe pse këto transferime janë shoqëruar me problematika në lidhje me mjaftueshmërinë e tyre. **Si rezultat, u rritën burimet financiare në dispozicion të bashkive për përmbushjen e misionit dhe funksioneve të tyre.**

Nërkohë, pavarësisht përmirësimit të burimeve financiare të bashkive, Shqipëria ende qëndron nën mesataren e vendeve të Evropës Juglindore (5,9%) përsa i takon raportit të fondeve totale në dispozicion të bashkive si përqindje ndaj PBB (5,9% Evropa Jug-Lindore dhe 5% Shqipëria) dhe raportit të të ardhurave nga burimet e veta ndaj burimeve totale (34,4% Evropa Jug-Lindore dhe 29,1% Shqipëria). Figura e mëposhtme krahason raportin e të ardhurave të veta ndaj totalit të të ardhurave vendore për 61 bashkitë e vendit për vitin 2018. Të dhënat e vërtetojnë (i) se vetëm 23 bashki qëndrojnë mbi mesataren kombëtare (15%), (ii) diferencimin e Bashkisë Tiranë.

Figura 6. Autonomia Vendore



Burimi: www.financatvendore.al

Theksojmë se mesatarisht, totali i fondeve për të cilat bashkitë kanë diskrecion të plotë në përdorimin e tyre zë rreth 55% të burimeve totale financiare. Të ardhurat nga burimet e veta vendore janë thelbësore për një qeverisje vendore të mirë dhe të pavarur. Në buxhetin vendor, kjo kategori të ardhurash përfaqësoi rreth 29,1% ndaj burimeve financiare totale në vitin 2018 i përmirësuar krahasuar me një vit më parë. **Në këtë përmirësim vlerësohet të kenë ndikuar rritja e nivelit të taksave dhe tarifave vendore në disa prej bashkive por dhe përmirësimi i mundshëm në normën e mbledhjes së të ardhurave.**³⁸

Roli i të ardhurave nga taksat, tarifat dhe burimet e tjera vendore në buxhetin vendor ndryshon ndjeshëm ndërmjet 61 bashkive në vend. Për rreth 28 nga 61 bashki, të ardhurat nga taksat përfaqësojnë mbi 50% të të ardhurave nga burimet e veta³⁹. Në 31 bashki, janë të ardhurat nga tarifat të cilat përfaqësojnë mbi 50% e këtyre nga burimet e veta vendore të bashkisë⁴⁰. Ndërkohë, **kapaciteti i bashkive për të gjeneruar të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore**, gjithashtu, paraqet diferenca të theksuara ndërmjet bashkive: **rreth 61,8% e të ardhurave totale nga taksat vendore mbledhet në Bashkinë Tiranë**, ndjekur nga ajo Durrës⁴¹ me rreth 5,2%, nën

38 www.financatvendere.al

39 Bashkitë Vlorë, Ura Vajgurore, Tiranë, Shijak, Roskovec, Lezhë, Kavajë dhe Durrës mbledhin të ardhura nga taksat vendore mbi mesataren kombëtare prej rreth 59.7%, www.financatvendore.al

40 Në Bashkitë Bulqizë, Kamëz, Kukës, Kuçovë, Patos, Pukë dhe Skrapar tarifat vendore kontribuojnë me më shumë se 70% në të ardhurat nga burimet e veta vendore të bashkisë, www.financatvendore.al

41 Praktikisht, pesha e bashkive ndaj totalit të të ardhurave si nga taksat ashtu dhe nga tariffat vendore, sugjeron për një hendek të madh në terma të kapaciteteve fiskale ndërmjet bashkisë Tiranë dhe 60 bashkive të tjera. Bashkia Tiranë mbledh të ardhura sa 60 bashkitë e tjera së bashku, respektivisht për vitin 2018 Bashkia Tiranë ka mbledhur 13

efektin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja. Panoramë e ngjashme paraqitet edhe në rastin e të ardhurave nga tarifat vendore: Bashkia Tiranë mbledh rreth 43% të totalit, ndjekur nga Bashkitë Kamëz dhe Durrës me 5,8% dhe 4,7%, përkatësisht. Pra, taksat dhe tarifat janë burim i rëndësishëm të ardhurash për bashkitë. Ndërkohë, theksojmë se ka një diferencim të theksuar sa i takon mbledhjes së të ardhurave fiskale midis Bashkisë Tiranë dhe bashkive të tjera, ku ndikim të madh ka taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja.

3. Planet Vendore të Zhvillimit - Roli i Biznesit

Planet e përgjithshme Vendore janë instrumenta shumë të rëndësishëm, në të cilat bazohet zhvillimi territorial i bashkive dhe mundëson hapësirat për zhvillimin ekonomik të saj. Bazuar në ligjin 107/2014 *“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”*, Kryetari i bashkisë është përgjegjës për hartimin e planit të zhvillimit të territorit i cili më pas duhet të miratohet nga KB. Referuar të dhënave të publikuara⁴², aktualisht 31 bashki kanë miratuar PPV, 12 janë në proces hartimi të PPV, ndërsa 18 bashki nuk kanë PPV.

PPV zbatohen nëpërmjet planeve sektoriale, planeve të detajuara vendore dhe ljeve të zhvillimit. Planet sektoriale në nivel bashkie hartohen në zbatim të planit të përgjithshëm vendor dhe përcaktojnë zhvillimin strategjik të sektorëve të ndryshëm në territorin administrativ të bashkisë.

miliard lekë, ndërsa 60 bashkitë e tjera 11 miliardë lekë. Përfashtuar bashkinë Tiranë, diferencat mes bashkive vijnë të jenë të theksuara midis bashkive qendra qarku (bashkitë e mëdha) dhe 49 bashkive të tjera.

42 <http://www.azht.gov.al/all/instrumentet-e-planifikimit/planet-e-pergjithshme-vendore-44-ppv>

Hartimi i këtyre planeve në bashkëpunim dhe pjesmarrje të grupeve të interesit dhe në veçanti të biznesit, si edhe bërja publike e tyre duke rritur transparencën janë thelbësore për nxitjen dhe zhvillimin ekonomik të bashkive.

PPV zbatohen të lidhura ngushtë me Plan-et Strategjike të Zhvillimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore⁴³.

STRATEGJI DHE LIGJE

1. Strategjia Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015-2020

Strategjia përbën dokumentin e përmbledhur të vizionit mbi vetëqeverisjen vendore dhe procesit të decentralizimit⁴⁴. Ajo u miratua menjëherë pas miratimit të Ligjit 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Shtyllat kryesore të objektivave të identifikuar nga strategjia ishin si më poshtë:

1. Rritja e efikasitetit të strukturave të vetëqeverisjes vendore:

- (a) Konsolidimi territorial i njësive të qeverisjes vendore të nivelit të parë dhe nivelit të dytë;
- (b) Përmbyllja e procesit të decentralizimit të kompetencave në funksionet e përbashkëta dhe ato të deleguara. Në strategji përmendet edhe mbështetja financiare që do të jepet për njësitë e qeverisjes vendore kur këto të fundit nuk janë në gjendje të arrijnë të plotësojnë standardet kombëtare të kërkuara;
- (c) Rishikimi i kompetencave në funksionet e

⁴³ Neni 32 i Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”

⁴⁴ Reforma e decentralizimit është nisur që në 1999 mbështetur në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore (1999) dhe Strategjisë Kombëtare të Decentralizimit (1999)

përbashkëta do të harmonizohet dhe bashkërendohet me reformimin e nivelit të dytë të qeverisjes vendore si edhe me procesin e rajonalizimit.

2. Forcimi i financave të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe rritja e autonomisë fiskale:

- (a) Reforma e decentralizimit do të krijojë mundësi që qeveritë vendore të kenë më shumë burime financiare. Për të arritur këtë synim, u parashikuan nisma të rëndësishme ligjore, duke përfshirë hartimin e ligjit të ri integral për financat e qeverisjes vendore, të paketës së re të decentralizimit fiskal, i cili do të përfshijë zbatimin e konceptit të ndarjes së taksave kombëtare, si dhe përmirësimin e kritereve të ndarjes së transfertës së përgjithshme nga buxheti i shtetit për qeveritë vendore.
- (b) Të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm vendor duke synuar ndërtimin e një modeli të ri të harmonizuar të zhvillimit social-ekonomik dhe territorial, duke synuar uljen e pabarazisë në zhvillim midis zonave dhe territoreve të ndryshme të vendit dhe mbështetjen e qeverisjes vendore në nismat për zhvillim vendor.

3. Të forcojë qeverisjen e mirë në nivel vendor:

- (a) Forcimi i transparencës dhe pjesëmarrjes së komuniteteve, biznesit dhe shoqërisë civile në vendimmarrjen publike në nivel vendor. Do të rishikohet kuadri ligjor dhe do të ngrihet një sistem i veçantë për “monitorimin e performancës në nivel vendor” si mekanizëm për të garantuar llogaridhënien e administratës publike dhe efikasitetin e shërbimeve në nivel vendor.
- (b) Fuqizimi i administratës vendore. Qëllimi

kryesor në ecurinë e reformës së administratës publike në nivel vendor do të jetë konsolidimi i një administrate vendore të çburokratizuar, të paanshme politikisht, profesioniste dhe transparente. Ajo do të jetë e gatshme t'i përgjigjet pritshmërive të komuniteteve dhe biznesit për shërbime publike, e aftë që të përballojë sfidat e integritetit evropian të vendit dhe thithjen e fondeve të BE, duke respektuar gjithmonë standardet, të cilët janë njëkohësisht edhe prioritetet e reformës së administratës publike në nivel vendor.

- (c) Përmirësimi i marrëdhënieve ndër-institucionale midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore. Do të ndërtohen mekanizmat formalë dhe funksionalë të dialogut ndër-institucional midis qeverisë qendrore dhe asaj vendore. Vendimmarrja me ndikim në qeverisjen vendore do të jetë më gjithëpërfshirëse dhe do të merret duke u konsultuar më parë me përfaqësuesit e qeverisjes vendore.

Për zbatimin e startegjisë u identifikuan mbi 150 masa të cilat duhet të zbatohen gjatë periudhës 2015-2020 në kuadër të plan-veprimt të detajuar, ku një pjesë e madhe e tyre lidhen me rishikimin dhe miratimin e paketës së plotë ligjore në lidhje me vetëqeverisjen vendore.

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur dhe për qëllime të temës objekt diskutimi në KI midis shumë ligjeve akteve nënligjore⁴⁵ janë analizuar veçanërisht vetëm ligjet e mëposhtme:

⁴⁵ Sfera e ligjeve dhe akteve nënligjore që lidhen me vetëqeverisjen vendore gjenden edhe në ligje të tjera si p.sh. Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar) apo Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për Taksat Kombëtare” (i ndryshuar).

2. Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”

Ky ligj vendosi kuadrin e ri normativ për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore me funksione e kompetenca të reja⁴⁶. Në bazë të këtij ligji, njësitë e vetëqeverisjes vendore organizohen vetëm në 2 nivele, bashkitë si nivel i parë dhe bazë i vetëqeverisjes vendore dhe qarku si nivel i dytë, duke eliminuar kështu komunat si njësi administrative në nivel vendor.

Ligji përcaktoi një fushë më të gjerë kompetencash dhe funksionesh të reja për Bashkitë, duke shmangur funksionet e përbashkëta dhe duke sanksionuar për herë të parë edhe konceptin e taksave dhe tarifave të ndara si kategori nga buxhetet kombëtare të të ardhurave. Funksionet e reja të cilat u janë kaluar bashkive janë:

- (a) Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave
- (b) Mirëmbajtja e rrugëve rurale
- (c) Infrastruktura e ujitjes dhe kullimi
- (d) Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi
- (e) Menaxhimi i qendrave sociale
- (f) Stafi mbështetës për sistemin e arsimit parauniversitar
- (g) Personeli mësimor dhe jo-mësimor në arsimin parashkollor

Një nga risitë e ligjit janë parashikimet e kreut VI sipas të cilin vendosen disa parime shumë të rëndësishme në raport me transparencën dhe pjesëmarrjen publike në vendimmarrjen e Bashkisë⁴⁷ duke e bërë konsultimin paraprak me publikun të detyrueshëm.

Nga ana tjetër u parashikua edhe konsultimi midis qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëq-

⁴⁶ Ky ligj zëvendësoi dhe shfuqizoi ligjin e mëparshëm nr. 8542 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

⁴⁷ Këto parashikime janë në linjë edhe me parimet dhe dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative të miratuar me Ligjin nr. 44/2015.

everisjes vendore si një detyrim për politikën, le-
gjislacionin dhe normat që rregullojnë dhe kanë
ndikim të drejtpërdrejt në ushtrimin e të drejtave
dhe funksioneve të këtyre njësive⁴⁸.

3. Ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”

Ligji nr. 68/2017 u miratua duke patur si synim
arritjen e objektivave të mëposhtme:

1. Forcimin e autonomisë financiare, nëpërmjet vendosjes së parimeve të autonomisë fiskale vendore, rritjes së transfertës së pakushtëzuar dhe lidhjes së madhësisë së saj vjetore me një variabël makroekonomik si 1% e Prodhimit të Brendshëm Bruto, i cili pritet të rrisë në mënyrë të ndjeshme të ardhurat, stabilitetin dhe parashikueshmërinë e fondeve të disponueshme për qeverisjen vendore; dhe ndarjen, për herë të parë, të 2% të të ardhurave nga Taksa mbi të Ardhurat Personale (TAP) me qeverisjen vendore.
2. Forcimin e disiplinës fiskale, nëpërmjet vendosjes së parimeve, rregullave, proceseve dhe procedurave për hartimin, konsultimin, miratimin, publikimin, zbatimin, rishikimin e buxheteve vjetore dhe afatmesme të njësive të vetëqeverisjes vendore (p.sh. Nenet 33 dhe vijues); nëpërmjet përcaktimit të rregullave dhe procedurave për menaxhimin e situatave të vështirësive financiare dhe pa aftësisë pague (p.sh. Nenet 55 dhe vijues).
3. Rritjen e transparencës, nëpërmjet përfshirjes së kërkesave ligjore për transparencën dhe nevojën e angazhimit të qytetarëve në vendimarrje gjatë procesit të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të dokumenteve të planifikimit strategjik, buxhetimit dhe

48 Neni 12/1 i ligjit.

menaxhimit të fondeve publike vendore në përgjithësi.

4. Unifikimin nëpërmjet harmonizimit të proceseve dhe procedurave për buxhetin vendor me buxhetin qendror⁴⁹ dhe hartimit të përkufizimeve të këtij ligji me ligjet e tjera, si ligji për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin etj.
 5. Forcimi i dialogut ndërqeveritar, nëpërmjet përcaktimit të proceseve dhe instrumenteve për konsultimin dhe dialogun ndërmjet qeverisjes qendrore dhe vendore, për transferimin e kompetencave dhe të funksioneve, burimeve të financimit dhe marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare në përgjithësi (p.sh. Neni 9 i cili konfirmon Këshillin Konsultativ të Vetëqeverisjes Vendore me Qeverisjen Vendore si forumi zyrtar i konsultimit paraprak të masave që prekin njësitë e vetëqeverisjes vendore)
- Risitë e ligjit:
- (1) Ligji nr. 68/2017 pranohet se ofron një kuadër të detajuar ligjor sa u takon financave në nivel vendor⁵⁰. Ky ligj liston në mënyrë të detajuar dhe nominale taksat dhe tarifave vendore si edhe taksat që ndahen midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore⁵¹.

49 Për herë të parë të gjitha bashkitë do të buxhetojnë në bazë të një Sistemi të Unifikuar Buxhetimi Afatmesëm

50 “Qeverisja Vendore në Shqipëri-Raport Mbi Situatën Aktuale”-Tiranë 2019

51 2. Taksat kombëtare që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes vendore janë:

a) 97 për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë;

b) 25 për qind e të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura;

c) 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për taksat kombëtare;

ç) 2 për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat

- (2) Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 25 të tij materializon edhe parimin e decentralizimit fiskal sipas të cilit: “*Në rastet e ndryshimeve në politikën fiskale, që shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe taksave të ndara, njësitë e vetëqeverisjes vendore kompensohen financiarisht, në përputhje me nivelin e uljes së të ardhurave.*” Ligji nr. 68/2017 për herë të parë vendos edhe rregulla konkrete në lidhje me vendosjen e taksave të përkohshme nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore (p.sh. Neni 13)⁵² duke sqaruar elementët e taksës së përkohshme dhe duke zgjeruar konceptin e saj të parashikuar që në Ligjin nr. 9632 datë 30.10.2016 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (të ndryshuar).

Për vendosjen në zbatim të ligjit janë nxjerrë aktet nënligjore (VKM dhe Udhëzime) ndërkohë që akoma nuk janë miratuar/nxjerrë dy akte nënligjore që lidhen me auditimin e jashtëm të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe hartimin e regjistrit të personave fizikë dhe juridikë që kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifave vendore.

personale.

3. Të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës.

52 2. Vendosja e taksës së përkohshme paraprihet nga hartimi i planit, që përmban, të paktën:

a) përcaktimin e shërbimit apo investimit specifik që financohet nga taksa e përkohshme;

b) kohëzgjatjen e taksës së përkohshme, e cila nuk mund të zbatohet për më shumë se tre vjet nga hyrja në fuqi, dhe shumën totale e vjetore të të ardhurave që pritet të mbledhen;

c) koston dhe afatet e kryerjes së shërbimit e investimit, përfshirë pjesën që financohet nga taksa e përkohshme dhe nga burime të tjera, përfshirë edhe pjesën e financimit nga buxheti i bashkisë.

9. Njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk mund të aplikojnë me shumë se dy taksa të përkohshme gjatë një viti buxhetor.

4. Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar)

Pavarësisht se strategjia parashikonte për një kuadër ligjor të integruar në fushën e taksave vendore, rezultoi se Ligji nr. 9632 mbeti në fuqi edhe pas miratimit të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”. Të dyja ligjet kanë një qëllim pothuajse të njëjtë që është ai i përcaktimit të rregullave për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Ligji nr. 9632 ashtu sikurse dhe Ligji nr. 68/2017 parashikon taksat dhe tarifave vendore duke krijuar edhe mbivendosje me këtë të fundit, ndërkohë që parashikon disa procedura konkrete në aspektin tatimor në lidhje me pagimin e taksave dhe tarifave vendore.

KUADRI INSTITUCIONAL

Në planin institucional, reforma në lidhje me sistemin e vetëqeverisjes vendore u mbështet me krijim e një Agjencie të dedikuar dhe krijimin e Këshillit Konsultativ të Vetëqeverisjes Vendore me Qeverisjen Qendrore. Duke qenë se objekti i analizës së Sekretariatit nuk ka fokus direkt rolin e këtyre institucioneve apo përmbushjen e duhur të funksioneve nga ana e tyre⁵³, më poshtë është sjellë një informacion sintetik në lidhje me këto institucione:

53 Mbi rolin e këtyre institucioneve në kuadër të post reformës administrative territoriale janë bërë gjetje dhe rekomandime konkrete në Raport Auditimin e Performancës “Funksionimi i bashkive, në kuadër të reformës administrative-territoriale”, KLSH, 2018, një pjesë e të cilave janë përfshirë në pjesën e Gjetjeve të kësaj analize.

1. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes VENDORE (AMVV)

Agjencia është vijimi i Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale (AZRT)⁵⁴. Disa nga funksionet dhe detyrat e Agjencisë janë:

- (a) Mbështet ministrin përgjegjës për çështjet vendore në koordinimin e punës për zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e decentralizimit dhe qeverisjes vendore;
- (b) Monitoron zbatimin e Strategjisë Ndërsëktoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015–2020, si dhe planit të veprimit përkatës;
- (c) Informon periodikisht institucionet publike, grupet e interesit dhe qytetarët mbi çështjet që lidhen me qeverisjen vendore;
- (d) Bashkëpunon me strukturën përkatëse të ministrisë përgjegjëse për çështjet vendore për propozimin dhe përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore në zbatim të Strategjisë Ndërsëktoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015–2020;
- (e) Mbështet ministrin përgjegjës për çështjet vendore për krijimin dhe administrimin e një sistemi kombëtar unik, me synim zbatimin e funksioneve të deleguara të vetëqeverisjes vendore;
- (f) Siguron informacione lidhur me çështjet e

vetëqeverisjes vendore, me qëllim koordinimin e institucioneve publike qendrore e vendore dhe harton raporte, analiza periodike mbi këto çështje;

- (g) Ofron këshillim ligjor dhe teknik për njësitë e vetëqeverisjes vendore në procesin e ushtrimit të funksioneve të tyre;
- (h) Shërben si qendër e evidentimit dhe e promovimit të praktikave më të mira dhe/ose modeleve rekomanduese për çështjet e vetëqeverisjes vendore.

2. Këshilli Konsultativ i Vetëqeverisjes Vendore me Qeverisjen Qendrore⁵⁵

Është forumi kryesor me karakter konsultativ dhe jo vendimmarrës në të cilën qeverisja qendrore konsultohet me njësitë e vetëqeverisjes vendore për projekt-ligjet, projekt-vendimet e Këshillit të Ministrave, projekt-politikat dhe projekt-strategjitë që rregullojnë ose kanë ndikim të drejtpërdrejt në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Objekt i konsultimit mes qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, janë edhe funksionet dhe/ose kompetencat e deleguara pushtetit vendor, transferimi i funksioneve ose kompetencave të reja dhe propozimet e politikave për çështje që prekin interesat e pushtetit vendor, në përputhje me legjislacionin përkatës.

⁵⁴ Është krijuar me VKM nr. 83, dt. 28.01.2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale” ndërsa me VKM nr. 11, datë 12.01.2018 janë bërë disa ndryshime duke e ndryshuar emrin në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore. Është institucion në varësi të Ministrit të Brendshëm që është dhe ministri përgjegjës për çështjet vendore.

⁵⁵ Krijuar në bazë dhe për zbatim të Nenit 12 të Ligjit 139/2015 me VKM nr. 910, datë 21.12.2016 “Për Çështjet, Objekt Konsultimi, dhe Strukturën, Procedurën, Formën, Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”.

BIBLIOGRAFIA

1. *Strategjia Ndërsëktoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020*
2. *Raporti i Monitorimit të Strategjisë Ndërsëktoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020*
3. *Ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”*
4. *Ligji 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”*
5. *Ligji 9632/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (të ndryshuar)*
6. *Ligji 9975/2008 “Për Taksat Kombëtare” (të ndryshuar)*
7. *Ligji 9936/2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*
8. *Manual Praktik për procedurat e administrimit fiskal në njësitë e vetëqeverisjes vendore – UNDP 2019*
9. *Raport Vjetor Financat Publike Vendore, 2018, Ministria e Financave dhe Ekonomisë*
10. *Fiscal Decentralisation Indicators for South-East Europe, NALAS December 2018*
11. *qeverisja vendore në Shqipëri, Shoqta e Bashkive të Shqipërisë, 2019*
12. *Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018 – 2022*
13. *Apelimi Tatimor në nivel vendor – Udhërrëfyes USAID 2018*
14. *Public Expenditure and Financial Accountability (PEFA) assessment of Berat Municipality, Albania*
15. *Public Expenditure and Financial Accountability (PEFA) assessment of Tirana Municipality, Albania*
16. *Public Expenditure and Financial Accountability (PEFA) assessment of Tropojë Municipality, Albania*
17. *Public Expenditure and Financial Accountability (PEFA) assessment of Fier, Municipality, Albania*
18. *Faqja e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë: www.financa.gov.al*
19. *Portali i Financave Vendore: www.financavendore.al*
20. *Portali i publikimit të VKB: www.vendime.al*

RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomike
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjëse për përmbajtjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council